



GreenAL

Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile

Pasqyra e Programit GreenAL

Korrik 2024

Përditësuar Dhjetor 2024





Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje	5
2.	Përse ky dokument.....	13
3.	Temat dhe fushat e interesit	14
3.1.	Fushat prioritare	18
3.2.	Takime me institucionet publike	25
3.3.	Çështje të tjera për tu mbajtur në konsideratë.....	28
3.4.	Integrimi i Perspektivës Gjimore në projektet Mjedisore	29
3.5.	Bashkëpunimi me OSHC e rrjete rajonale.....	33
3.6.	Përafrimi me qellimet e projektit.....	34
3.7.	Thirrja për grante	36
3.8.	Procesi i vlerësimit të projekteve.....	40
4.	Zbatimi dhe Monitorimi	40
5.	Këshilla për aplikantët.....	41
6.	Komunikimi dhe promovimi i projektit/çështjeve mjedisore	42

Lista e figurave

Figura 1: Paraqitje grafike e aplikimeve dhe projekteve fituese në fazën e parë të GreenAL	6
Figura 2: Paraqitje grafike e shpërndarjes së mbështetjes financiare në fazën e parë të GreenAL.....	6
Figura 3: Paraqitja grafike e burrave/djemve dhe grave/vajzave pjesëmarrës në aktivitetet e fazes së parë të GreenAL.....	7
Figura 4: Ndarja rajonale e GreenAL.....	9
Figura 5: Paraqitje grafike e pjesëmarrjes së burrave/djemve dhe grave/vajzave në takimet e zhvilluara nga GreenAL.....	18
Figura 6: Ilustrim i pikave të monitorimit nga platforma digjitale Mushkri të Gjelbra	23
Figura 7: Ilustrim grafik i grupeve të interesit të kontaktuar nga Partnerët GreenAL	27
Figura 8: Ilustrim grafik i çështjeve mjedisore në fokus të GreenAL	35
Figura 9: Ilustrim grafik i skemës së granteve GreenAL	37
Figura 10: Ilustrim grafik i publikimit të thirrjeve për skemat e granteve në kuadër të GreenAL	39
Figura 11: Foto e faqes së internetit të GreenAL.....	43



Lista e grafikëve

Grafiku 1: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në tryezat e rrumbullakëta e takime të organizuara nga GreenAL.....	18
Grafiku 2: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në takimet e zhvilluara në rajonet GreenAL	19
Grafiku 3: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në takimet e zhvilluara në rajonet GreenAL	27

Shkurtime

- AKM- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- AREB- Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor
- ARM- Agjencia Rajonale e Mjedisit
- ARM- Agjencitë Rajonale të Mjedisit
- ARZM- Agjenci Rajonale të Zonave të Mbrojtura
- AZM- Administrata e Zonave të Mbrojtura
- BE- Bashkimi Europian
- BP- Ballkani Perëndimor
- Co-PLAN - Instituti për Zhvillimin e Habitatit
- COSV - Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario
- DRAP - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
- IKMT- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
- ISHP - Instituti i Shëndetit Publik
- KB- Këshilli Bashkiak
- KE - Këshilli Europian
- KTK- Komunikata e Tretë Kombëtare
- Nj.A - Njësi Administrative
- OJF- Organizata Jofitimprurëse
- OSHC- Organizata të Shoqërisë Civile
- PBB - Prodhimi i Brendshëm Bruto
- Sida- Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim
- SKZHI- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Europian



UNFCCC- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

VIS Albania - Volontarito Internazionale per lo Sviluppo

ZVA- Zyra Vendore Arsimore

Shënim!

Ky dokument paraqet elementet kryesore të projektit GreenAL dhe synon të ofrojë udhëzime të qarta për grupet e interesit lidhur me: 1) Fushat prioritare të ndërhyrjes; 2) Tipologjinë e mbështetjes financiare; 3) Mundësitë për rrjetëzim; 4) Elementet e komunikimit që pritet të adresohen gjatë zbatimit të projektit. Projekti GreenAL karakterizohet nga natyra e tij dinamike dhe shtrirja e konsiderueshme kohore. Për këtë arsye, ky dokument konsiderohet si një udhërrëfyes fleksibël, i cili mund të përditësohet periodikisht për të reflektuar zhvillimet e reja, sfidat e hasura dhe mundësitë e identifikuara. Këto përditësime mund të ndikojnë në qasjet e propozuara dhe datat e parashikuara të aktiviteteve të ndryshme të projektit. Grupet e interesit inkurajohen të konsultohen rregullisht me versionin më të fundit të këtij dokumenti për të qenë të informuar mbi ndryshimet dhe mundësitë e reja që mund të shfaqen gjatë ecurisë së projektit GreenAL.

“Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit”.



1. Hyrje

Projekti 'Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile' GreenAL synon të fuqizojë OSHC-të mjedisore Shqiptare, dhe jo vetëm, për të marrë pjesë dhe kontribuar në mënyrë efektive dhe direkte në procesin e negociatave për anëtarimin në BE, me fokus kryesor Kapitullin 27, Mjedisin. Gjithashtu nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për 4 vitet e ardhshme (2024-2027) GreenAL kërkon të kontribuojë në mënyrë proaktive në adresimin e sfidave mjedisore, nëpërmjet advokimit, ndikimit në politika dhe monitorimit nga niveli lokal në atë kombëtar duke pasur në fokus përfshirjen aktive të komuniteteve.

Ky projekt financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Partnerët GreenAL, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat, VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.

GreenAL ndërton mbi praktikën e mira dhe mësimet e nxjerra të fazës së parë të GreenAL (2021 – 2023) duke vijuar mbështetjen e OSHC-ve, kryesisht atyre me fokus mjedisor, por jo vetëm, për të ngritur problematikat mjedisore të cilat prekin komunitetet në terriore të ndryshme të vendit për të nxitur advokimin të bazuar në fakte/monitorime dhe pjesëmarrje në proceset e politikbërjes nga niveli lokal në atë kombëtar duke synuar rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në vendimarrje.

Gjatë fazës së parë të projektit GreenAL në të dy thirrjet e hapura për projekt propozime kanë ardhur një total prej 103 aplikimesh nga të cilat janë shpallur fitues 31 projekt propozime duke mbështetur financiarisht rreth 50 OSHC.






Figura 1: Paraqitje grafike e aplikimeve dhe projekteve fituese në fazën e parë të GreenAL

Mbështetja financiare për OSHC-të ka qënë në vlerën 800,000 € nga të cilat janë disbursuar 753,016 €.




Figura 2: Paraqitje grafike e shpërndarjes së mbështetjes financiare në fazën e parë të GreenAL



Një nga elementët kryesorë të fazës së parë ka qënë edhe zhvillimi i 5 Forumeve Tematike Mjedisore ku rreth 80 OSHC mjedisore, dhe jo vetëm, patën mundësi të faktorizonin punën dhe advokonin për adresimin e çështjeve mjedisore të ngritura prej tyre. Në aktivitetet e zhvilluara nga GreenAL përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së projektit kanë marrë pjesë në mënyrë aktive një sërë aktorësh, përshi përfaqësues të OSHC-ve, institucioneve publike e arsimore e konsulentë të pavarur.



OSHC - 259



Institucione publike - 60



Institucione arsimore - 23



Konsulentë të pavarur - 49

Në total në këto aktivitete kanë marrë pjesë rreth 943 persona, ku pjesa më e madhe e tyre , 537, kanë qënë gra dhe vajza.



43% burra dhe djem



57% gra dhe vajza

Figura 3: Paraqitja grafike e burrave/djemve dhe grave/vajzave pjesëmarrës në aktivitetet e fazës së parë të GreenAL



Objektivat specifike:

- Të mbështesë dhe fuqizojë më tej OSHC-të mjedisore në Shqipëri duke forcuar kapacitetet e tyre për të trajtuar në mënyrë proaktive çështjet mjedisore dhe konsoliduar legjitimitetin e tyre për të përfaqësuar më mirë kauzën e tyre dhe/ose komunitetet e prekura;
- Të stimulojë dhe inkurajojë përfshirjen aktive të OSHC-ve mjedisore në proceset e vazhdueshme dhe të ardhshme që lidhen me *Acquis*, me fokus kryesor Kapitullin 27, Mjedisin dhe tranzicionin e gjelbër në nivel lokal, rajonal, kombëtar;
- Të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve dhe llogaridhënies së vendimmarrësve mbi sfidat e ndryshimeve klimatike, ndotjes dhe mbrojtjes së natyrës nëpërmjet monitorimit advokimit dhe ndikimit në politikbërje.

Territori i veprimit dhe partnerët

Projekti do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme organizatave dhe grupeve të interesit, Partnerët GreenAL kanë vendosur të ndajnë territorin e vendit në 3 rajone kryesore. Secili nga Partnerët do të ofrojë asistencë dhe mentorim për të gjithë ato OSHC dhe grupe të tjera interesi të cilat do të duan të aplikojnë e zbatojnë projekte në rajonet respektive duke synuar:

- Mbështetjen e OSHC-ve mjedisore për të konsoliduar pozicionin e tyre në bashkinë/rajonin në të cilin operojnë;
- Rritjen e sinergjive ndërmjet OSHC-ve, ekspertëve, aktivistëve, bizneseve dhe institucioneve publike;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe grupeve të interesit për çështjet mjedisore.



Rajonet dhe partnerët përgjegjës do të jenë si më poshtë:

VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo, është përgjegjës për Rajonin Verior.

Co-PLAN - Instituti për Zhvillimin e Habitatit, është përgjegjës për Rajonin Qendror.

COSV - Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, është përgjegjës për Rajonin Jugor



Figura 4: Ndarja rajonale e GreenAL

Ekspertiza e Partnerëve

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, vjen me një eksperiencë të gjatë në menaxhimin e granteve dhe një portofol të gjerë mjedisor. Co-PLAN është angazhuar që nga viti 1995 të faktorizojë dhe përfshijë perspektivat mjedisore në agjendën lokale dhe kombëtare nëpërmjet dialogut sistematik me institucionet qendrore dhe angazhimit të komunitetit. Për të krijuar qasje sa më të zbatueshme dhe të kontekstualizuara, Co-PLAN ka prioritetizuar fokusin në mjedis duke ndërmarrë projekte të ndryshme që synojnë zbatimin e praktikave të qëndrueshme të planifikimit dhe menaxhimit për burimet natyrore, adresimin e ndryshimeve klimatike, reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe kryerjen e monitorimit të ndotjes në ajër, tokë dhe ujë. Për më tepër informacion vizitoni [faqen këtu](#).

VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo (Shërbimi Ndërkombëtar Vullnetar për Zhvillim) është një degë e VIS International, e pranishme në Shqipëri që nga viti 1995. Fillimisht fushëveprimi i VIS Albania ka qenë e orientuar në mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve Shqiptar, por përgjatë viteve kjo ka ndryshuar dhe misioni i VIS është bërë: Orientimi i shoqërisë shqiptare drejtë një angazhimi të ndërgjegjshëm, nëpërmjet veprimit dhe marrjes pjesë në vendimmarrje, për të sjellë përmirësimin e jetës. Në Shqipëri VIS aplikon qasjen 'Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti' në fushën e zhvillimit rural dhe për fuqizimin e komuniteteve lokale. Për më tepër informacion vizitoni [faqen këtu](#).





Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario (COSV) është një shoqatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 1968 dhe e angazhuar në ndërhyrje për zhvillim dhe ndihmë humanitare në Evropë, Ballkan, Afrikën Jugore dhe Lindjen e Mesme. Operon për paqe, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e mjedisit, për të përmirësuar realitetet lokale dhe krijuar një ndikim afatgjatë. Puna e COSV-it është frymëzuar nga "kultura e bashkëpunimit" dhe është e orientuar për rindërtimin e kapitalit të përbashkët dhe për vendosjen e marrëdhënieve të forta, me qëllim mbështetjen e transformimeve politike dhe ekonomike që qëndrojnë në themel të progresit. Për më tepër informacion vizitoni [faqen këtu](#).


Struktura manaxheriale e projektit

GreenAL përmban disa nivele menaxhimi:

1. **Struktura drejtuese e projektit**, struktura më e lartë vendimmarrëse.
2. **Komiteti operacional**, niveli i dytë i vendimmarrjes.
3. **Skudra zbatuese**, struktura thelbësore e zbatimit të projektit. Kjo skuadër merret me menaxhimin dhe koordinimin e përditshëm ndërmjet partnerëve të projektit dhe përfituesve të skemës së granteve.
4. **Skudra suportuese**, që përbëhet nga Pikat Fokale Rajonale (RFP) dhe ekspertët tematikë. Si RFP-të ashtu edhe ekspertët tematikë do të ofrojnë mbështetjen dhe mentorimin e nevojshëm për organizatat.

Më poshtë mund të gjeni një paraqitje skematike e strukturës së menaxhimit dhe niveleve të komunikimit në projektin GreenAL.

Bazuar në logjikën nga poshtë-lart, e paraqitur në anën e djathtë, të gjitha strukturat sipas hierarkisë sugjerojnë ndryshime, ngrenë probleme dhe nënvizojnë praktikatat e mira. Nga ana tjetër, në anën e majtë të diagramit, tregohet qasja nga lart-poshtë ku strukturat hierarkike marrin vendime, i komunikojnë ato dhe ofrojnë ndihmë për çështje specifike në varësi të nevojave të projektit dhe grupit të punës.





Grupi i dedikuar për koordinimin e projektit GreenAL nga **Co-PLAN** përfshinë:

- **Imeldi Sokoli, menaxheri i projektit GreenAL**, është një ekspert me përvojë në qeverisjen territoriale dhe zhvillimin urban. Që nga viti 2019, ai ka bashkëpunuar me OSHC, duke mbështetur menaxhimin e granteve të vogla dhe fuqizimin kapaciteteve për adresimin e çështjeve mjedisore, si ndotja e ajrit dhe gjelbërimi urban. Ekspertiza e tij përfshin dhe hartimin e Planeve për Menaxhimin e Mbetjeve, Strategji për Reduktimin e Rrezeve nga Fatkeqësitë dhe Plane Lokale për Efikasitetin Energjetik.
- **Ogerta Gjijnuri, menaxherja e financave**, është një profesioniste me më shumë se 20 vjet ekspertizë e aplikuar në financë dhe në çështjet e menaxhimit financiar. Ajo ka përvojë të gjerë në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë ato jofitimprurës dhe fitimprurës.
- **Enkela Poro, menaxherja e granteve**, është diplomuar me titullin Mastër Shkencor në Universitetin Politeknik të Tiranës, për Inxhinieri Mjedisi, e specializuar për Trajtim Uji. Ajo ka mbi dy vite eksperiencë në rolin e menaxherit të granteve të vogla.
- **Rudina Çopa, RFP e rajonit qendror**, ka përfunduar studimet Master në Inxhinieri Mjedisi. Ajo ka disa vite eksperiencë si inxhinierë mjedisi në sektorin publik dhe në organizata joqeveritare dhe është e certifikuar si eksperte mjedisore dhe audituese e energjisë.
- **Greta Shehu, eksperte GIS**, është e diplomuar në degën Studime Mjedisore dhe aktualisht po ndjek një diplomë Master në Menaxhim Mjedisor Urban, duke avancuar më tej ekspertizën e saj në zhvillimin e qëndrueshëm urban.
- **Klesta Galanxhi, eksperte për dizajn dhe multimedia**, ka përfunduar studimet Master në Multimedia dhe është një profesioniste me më shumë se 10 vjet përvojë në multimedia dhe komunikim vizual.

Grupi i dedikuar për koordinimin e projektit GreenAL nga **VIS Albania** përfshinë:

- **Sonila Hoxholli Kocli, RFP e Rajonit Verior**, ka një përvojë të gjatë në zbatimin e projekteve në fushën e zhvillimit social-ekonomik me fokus në çështjet e zhvillimit rural, ekoturizmit dhe mjedisit. Gjithashtu vjen me mbi 5 vjet eksperiencë si koordinatorë lokale e projekteve.
- **Gentjan Gjinaj**, vjen me përvoja në projekte të ndryshme me fokus në çështjet mjedisore dhe jo vetëm. Ai ka punuar më së shumti në projekte lokale me qëllimin e organizimit të komunitetit, si një mënyrë për zhvillimin e zonave rurale.

Grupi i dedikuar për koordinimin e projektit GreenAL nga **COSV** përfshinë:

- **Jonida Shano, RFP e rajonit jug-lindor (Korcë, Berat)**, është diplomuar për Ekonomi Biznesi - Marketing Territorial. Ajo ka mbi 15 vjet përvojë profesionale në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e territorit, turizmin, zhvillimin rural dhe ngritjen e kapaciteteve të subjekteve publike dhe private.
- **RFP e rajonit jug-perëndimor (Gjirokastrë, Vlorë)**

Ekspertiza tematike e deritanishme e GreenAL përfshinë ekspertët e mëposhtëm:





- **Rodion Gjoka, ekspert i ndotjes**, ka mbi 6 vjet përvojë të gjerë në punime, projekte, studime, programe dhe politika mjedisore, si dhe në vlerësimin dhe analizën mjedisore me fokus në mbrojtjen e mjedisit, raportimin dhe menaxhimin e burimeve, etj.
- **Kejt Dhrami, ekspertja e ndryshimeve klimatike**, ka përfunduar studimet doktorale mbi lidhjen mes tipologjiive hapësinore, morfologjisë urbane dhe indikatorëve të zhvillimit të tokës. Ajo ka mbi 8 vjet eksperiencë pune në fushën e planifikimit rajonal, vendor dhe sektorial, në hartimin e planeve të reduktimit të riskut ndaj fatkeqësive natyrore, etj.
- **Merushe Zeneli, ekspertja e çështjeve gjinore**, ka përfunduar studimet bachelor për Sociologji dhe studimet Master në 'Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut në Evropën Juglindore' tek Universiteti i Bolonjës, ku ka mbrojtur temën e diplomës 'Orientimi seksual dhe identiteti gjinor'. Merushe mbi 3 vite eksperiencë në trajtimin e çështjeve gjinore.

2. Përse ky dokument

Për sa i përket sektorit të mjedisit në vend, por edhe më gjerë, ai është në një gjendje evolucioni të vazhdueshëm, i karakterizuar nga hartimi i legjislacionit të ri dhe miratimi i praktikave të reja që synojnë zbutjen e ndikimit të ndotjes dhe efekteve të ndryshimeve klimatike në mjedis. Gjatë 5 viteve të fundit Qeveria Shqiptare me mbështetjen e donatorëve ka hartuar disa dokumente strategjike të cilat do të udhëheqin vendimmarrjen dhe hartimin e politikave në sektorin e mjedisit për vitet në vijim.

Në këtë drejtim dokumenti strategjik i cili përmbledh në mënyrë të integruar prioritetet e Qeverisë Shqiptare në raport edhe me proceset e Integritimit European është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim European 2030, SKZHI III. SKZHI III është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rrugën e integritimit të tij në Bashkimin European.

SKZHI III zhvillohet mbi tre shtylla kryesore të cilat ndërlidhen me njëra tjetrën në funksion të arritjes së vizionit dhe integritimit të vendit në BE, të cilat janë si në vijim:

- Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë;
- Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër;
- Kohezioni social.

Në këtë dokument dhe veçanërisht në shtyllën e parë, nxitet dhe vlerësohet roli i shoqërisë civile si: **i) përfaqësues të interesave të grupeve qytetare; ii) mbajtës të njohurive kritike të domosdoshme** për suksesin dhe qëndrueshmërinë e reformave, politikave sektoriale dhe progresit të vendit drejt BE-së; dhe, **iii) partnerë të institucioneve dhe faktorë në suksesin e reformave**, të zhvillimit të vendit dhe progresit të vendit drejt BE-së.

Në këtë drejtim duke qenë se hartimit i politikave mjedisore dhe social – ekonomike janë në evolucion të vazhdueshëm është gjithnjë e më e nevojshme që OSHC-të të luajnë një rol aktiv si si përfaqësues të zërit të komunitetit në proceset politikbërëse.

Ky dokument shërben si një udhëzues gjithëpërfshirës për OSHC-të që kërkojnë mbështetje financiare përmes projektit GreenAL. Qëllimi kryesor është të lehtësojë procesin e aplikimit, duke siguruar që të



gjitha OSHC-të të kenë informacionin dhe burimet e nevojshme për të aplikuar me sukses për financimin e idesë së tyre.

GreenAL është i përkushtuar për të nxitur iniciativa me impakt të lartë mjedisor, duke ditur rolin që luajnë OSHC-të në nxitjen e ndryshimeve të qëndrueshme në nivel komuniteti. Ky dokument përshkruan fushat kryesore të fokusit mjedisor të programit, duke përfshirë zbutjen e ndryshimeve klimatike, monitorimin e ndotjes, ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve. Duke i përafuar projektet e tyre me këto tema prioritare, OSHC-të mund të rrisin shanset e tyre për të marrë mbështetje financiare dhe behën pjesë e një rrjeti i cili kontribuon në rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore.

Përveç ofrimit të indicieve/udhëzimeve të aplikimit, ky dokument ofron njohuri mbi sfidat specifike mjedisore që synon të adresojë programi si dhe një ‘fotografi’ të proceseve që do të ndodhin përgjatë 4 viteve të zbatimit të GreenAL.

3. Temat dhe fushat e interesit

Rajoni i Mesdheut për shkak edhe të tipologjisë së tij është një rajon i cili konsiderohet si shumë i cënueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Për shkak të përqendrimit të aktivitetit njerëzor rajoni ka pësuar ndryshime të shumta duke akomoduar një popullsi totale prej rreth 500 milion njerëzish të cilët janë përqëndruar kryesisht në vendbanime urbane në afërsi të bregdetit¹. Ky rajon vlerësohet i cënueshëm kryesisht nga mungesa e ujit, thatësisrat, rritja e temperaturave, rritja e nivelit të deteve, erozioni bregdetar, përmybtjet, zjarret të cilat me gjasë do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik e social të vendeve mesdhetare. Shqipëria, si një prej vendeve të rajonit të Mesdheut, pozicionohet në Ballkanin Perëndimor dhe referuar Indeksit të Riskut Botëror (World Risk Index 2023) ajo ka një indeks rrisht “të lartë” dhe renditet e 6-ta në Evropë dhe e 76-ta në Botë për sa i përket rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore. Vendi konsiderohet veçanërisht i ekspozuar ndaj tërmeteve, cunameve, përmybtjeve, cikloneve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit.

Skenarët e ardhshëm klimatikë për Shqipërinë parashikojnë ndryshime si: **a) rritje të temperaturave vjetore dhe sezonale, si në vlera minimale ashtu edhe maksimale; b) ulje të reshjeve; c) reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme.** Sipas Komunikatës së Tretë Kombëtare (KTK) të Konventës Kuadër së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), deri në verën e vitit 2050, zona bregdetare nuk ka gjasa të përjetojë temperatura mesatare nën 25°C; deri në vitin 2100, temperatura mesatare deri në 30°C pritet të dominojnë të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, të gjithë skenarët parashikojnë një ulje të mundshme të reshjeve sezonale në të gjitha stinët krahasuar me vlerat e vitit 1990.

Ndërkohë, BE-ja ka miratuar Marrëveshjen e Gjellbër, një nismë politike ambicioze që synon adresimin e ndryshimeve klimatike, promovimin e qëndrueshmërisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike brenda Bashkimit Evropian. Marrëveshje e pranuar edhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Dekleratës, së Sofies, së përbashkët të liderve të këtij rajoni. Kjo deklarata parashikon një grup angazhimesh dhe një plan veprimi

1 Cross-Chapter Paper Leads: Mediterranean Region. IPCC Sixth Assessment Report



në 5 shtylla kryesore: a) klima, energjia, lëvizshmëria/transporti; b) ekonomia qarkulluese; c) ndotja; d) bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; e) biodiversiteti.

Megjithatë, pavarisht njohjes së Marrveshjes së Gjelbërt dhe nevojës për masa konkrete, zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe nisja e iniciativave për arritjen e objektivave të saj paraqet sfida të rëndësishme për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa ka nevojë për burime financiare dhe vullnet të fortë politik për zbatimin e suksesshëm, BE-ja ka krijuar mekanizma për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në aksesin e fondeve që synojnë arritjen e këtyre objektivave.

Shqipëria konsiderohet një vend në zhvillim dhe referuar projeksioneve të Bankës Botërore pritet që për vitet e ardhshme të ketë një rritje ekonomike në nivelet e 3.3% të PBB, të nxitura kryesisht nga konsumi privat, rritja e turizmit dhe ndërtimeve. Nga njëra anë rritja ekonomike mund të konsiderohet pozitive pasi me gjasë do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe uljen e nivelit të varfërisë por nga ana tjetër do të shtojë presionin ndaj mjedisit dhe burimeve natyrore në favor të zhvillimit ekonomik, element të cilët nuk janë në linjë me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Po Shqipëria ku qëndron në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe marrjen e masave për zbatimin e Deklaratës së Sofies? Raportit i Monitorimit të 2023, për zbatimin e Deklaratës së Sofies, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal² evidenton disa arritje dhe sfida për fushat kryesore të cilat paraqiten më poshtë:

- 1. Dekarbonizimi:** Shqipëria ka shënuar përparime të rëndësishme në krijimin e kuadrit ligjor për ndryshimet klimatike, duke miratuar Ligjin për Ndryshimet Klimatike në dhjetor 2020. Megjithatë, ky ligj dhe legjislacioni mbështetës ka ende kërkonjë përshtatje për t'u harmonizuar plotësisht me Rregulloren e Qeverisjes së BE-së. Në aspektin e objektivave për energjinë dhe klimën, Shqipëria ka vendosur synime ambicioze për vitin 2030, duke synuar që 52% e energjisë në konsumin final bruto të jetë nga burimet e rinovueshme. Vendi synon gjithashtu një reduktim të emetimeve neto të gazeve serrë me 53.2% krahasuar me nivelet e vitit 1990, me emetime absolute prej 12.00 MtCO₂eq në 2030 (ose 20,9 % më të ulëta krahasuar me skenarin bazë). Shqipëria, së bashku me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, ka një nga emetimet më të ulëta të gazeve serrë për frymë në Evropë. Në fushën e efikasitetit të energjisë, Shqipëria ka transpozuar Direktivën përkatëse dhe ka bërë përparime në zbatimin e Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave. Megjithatë, nevojitet më shumë progres, veçanërisht në kontekstin e krizës energjetike. Është miratuar versioni i parë i Planit të Energjisë dhe Klimës, duke vendosur objektiva ambicioze për vitin 2030, përfshirë 52% energji nga burime të rinovueshme në konsumin final bruto. Sfidat kryesore përfshijnë përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të energjisë, thjeshtimin e procedurave administrative për projektet e rinovueshme, dhe zbatimin e plotë të legjislacionit të BE-së në fushën e energjisë. Përpjekje të vazhdueshme nevojiten për të përmbushur objektivat e 2030-ës dhe për të avancuar tranzicionin energjetik të vendit.
- 2. Ekonomia Qarkulluese:** Në fushën e ekonomisë qarkulluese, Shqipëria ka shënuar disa arritje të rëndësishme, por përballlet ende me sfida domethënëse. Vendi ka përfshirë konceptin e ekonomisë qarkulluese në Strategjinë e Investimeve dhe Zhvillimit të Biznesit (2021-2027) dhe ka nisur hartimin

² RCC, 2022: [Green Agenda Implementation Report](#)



e legjislacionit për sistemin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. Shqipëria dallohet për shkallën më të lartë të riciklimit të mbetjeve bashkiake në rajon (18.5%). Megjithatë, vendi ende nuk ka një strategji gjithëpërfshirëse për ekonominë qarkulluese dhe përballet me sfida në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve dhe sistemet grumbullimit të mbetjeve. Ndërgjegjësimi publik dhe nxitja e konsumit të qëndrueshëm mbeten fusha që kërkojnë vëmendje të veçantë pasi ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

3. **Reduktimi i Ndotjes:** Shqipëria ka bërë pak përparime në luftën kundër ndotjes, dhe ende përballet me sfida të rëndësishme. Vendi ka ratifikuar Konventën për Ndotjen Atmosferike Ndërkufitare në Distancë të Largët dhe dy nga tetë protokollet e saj. Megjithatë, Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit e miratuar në 2014 ka nevojë për përditësim dhe zbatim më efektiv. Në fushën e monitorimit të ajrit, Shqipëria ka shtatë stacione automatike monitorimi, por mbulimi dhe parametrat e monitoruar kanë nevojë për përmirësim pasi vendi nuk raporton ende të dhëna në Agjencinë Evropiane të Mjedisit. Lidhur me menaxhimin e ujërave, janë bërë përparime duke miratuar disa Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore, por ende ka nevojë për përmirësime në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të ndotura. Vetëm 16 impiante trajtimi janë funksionale në 2022. Përsa i përket mbrojtjes së tokës, Shqipëria ka nevojë për një kuadër ligjor më gjithëpërfshirës dhe përmirësim të sistemit të informacionit të tokës. Shqipëria ende duhet të forcojë zbatimin e legjislacionit mjedisor, të përmirësojë infrastrukturën e monitorimit dhe trajtimit të ndotjes, dhe të rrisë investimet në teknologji. Gjithashtu, nevojitet një qasje më e integruar ndërsektoriale për të adresuar në mënyrë efektive sfidat e ndotjes.
4. **Bujqësia e Qëndrueshme:** Shqipëria ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2021-2027, e cila synon të promovojë praktikën e qëndrueshme bujqësore dhe të rrisë efikasitetin e përdorimit të burimeve.³ Janë bërë përparime në harmonizimin e politikave bujqësore me standardet e BE-së, gjithsesi vendi ende ka nevojë për një politikë më koherente të sigurisë ushqimore dhe përmirësim të kontrolleve zyrtare. Në bujqësinë organike, Shqipëria po harmonizon kuadrin ligjor me BE-në, por zbatimi mbetet sfidues. Sipërfaqja e tokës nën bujqësi organike është rritur nga 2016-2020, por rritja ka qenë modeste (<0.10% e sipërfaqes bujqësore totale). Emetimet e gazeve serrë nga bujqësia kanë qëndruar relativisht të pandryshuara gjatë 2016-2020. Prioritetet kryesore përfshijnë përfundimin e regjistrimit të fermave, krijimin e rrjetit të të dhënave të kontabilitetit të fermave, forcimin e kapaciteteve administrative dhe promovimin e praktikave bujqësore miqësore me mjedisin.
5. **Mbrojtja e Biodiversitetit dhe Natyrës:** Vendi raporton se ka zgjeruar rrjetin e zonave të mbrojtura, duke mbuluar 21.3% të territorit, vlerësuar si përqindja më e lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, reduktimi dhe fragmentimi i zonave të mbrojtura, kryesisht ligatinore e bregdetare, mbetet ende shqetësues në kuadër të 'humbjes' së statusit të mbrojtur. Shqipëria ka një Indeks të Mbrojtjes së Specieve (SPI) mbi 50, që tregon një përfaqësim relativisht të mirë të specieve në zonat e mbrojtura. Megjithatë, vlerësimet e efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura mbeten të kufizuara, duke mbuluar më pak se 1% të tyre. Vendi ka identifikuar 43 site potenciale për rrjetin Natura 2000, por zbatimi i plotë i këtij rrjeti mbetet një sfidë. Ndërkaq, është hartuar një Dokument

³ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2021). Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2021-2027.



Strategjik për Politikën e Pyjeve (2018-2030), për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre⁴. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin ka përfunduar në vitin 2020 dhe ende nuk është përditësuar. Shqipëria ka nevojë të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të biodiversitetit, të përmirësojë sistemet e informacionit për biodiversitetin dhe të rrisë përpjekjet për restaurimin e ekosistemeve. Gjithashtu, nevojitet një qasje më e integruar ndërmjet politikave të biodiversitetit dhe atyre të ndryshimeve klimatike.

Nga ana tjetër, **Progres Raporti 2023 i KE për Shqipërinë** vlerëson se është arritur një **përparim i kufizuar** në përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjisllacionit me *Acquis* të BE-së. Raporti, evidenton se ndotja e ajrit, uji, menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura për trajtimin e tyre së bashku me mbrojtjen e natyrës janë çështje prioritare të cilat kërkojnë vëmendje nga ana e Qeverisë Shqiptare.

Si një vend në zhvillim, me shumë sfida përpara, ndër to edhe përafrimi i legjisllacionit, ku Kapitullin 27 konsiderohet si ndër më sfiduesit, kërkohet një qasje ndër-sektoriale dhe bashkëpunim ndërmjet të gjithë grupeve të interes për të adresuar problematikat dhe arritur objektivat.

Në këtë kontekst, roli i OSHC-ve merr një rëndësi të madhe, pasi ato luajnë një rol kyç jo vetëm në advokimin e shqetësimeve mjedisore, por edhe në ndikimin aktiv në proceset e politikbërjes duke siguruar që komunitetet të jenë të përfaqësuara dhe zhvillimi ekonomik është në paralel me atë social e mjedisor, e jo në kuriz të tyre.

Me qëllim validimin e qasjes, temave etj. Partnerët GreenAL përgjatë muajve prill, maj e qershor 2024 zhvilluan 9 tryeza të rrumbullakëta të cilat janë zhvilluar në 9 qytetet kryesore të qarqeve të vendit. Tryezat e rrumbullakëta kishin në fokusin e tyre OSHC-të, ekspertët mjedisor, aktivistët, të rinjtë e të rejtat të cilët duan të ngrenë e adresojnë çështje mjedisore në territorin që ata operojnë, duke i ilustruar atyre mundësitë për financim, angazhim dhe ngritje kapacitetesh që ofron programi GreenAL e nga ana tjetër këto tryeza shërbyen për të përfutur çështje mjedisore me interes që ata do të donin të përfshiheshin në program. Paralelisht me tryezat e rrumbullakëta janë zhvilluar edhe takime kryesisht me përfaqësues të institucioneve publike në nivel lokal, rajonal e kombëtar me qëllim përfshirjen e tyre në projekt si dhe përfitimin e nevojave të këtyre institucioneve lidhur me çështjet mjedisore të cilat mund të adresohen nëpërmjet bashkëpunimeve potenciale me OSHC-të. Në total në takime dhe tryeza të rrumbullakëta kanë marrë pjesë dhe janë konsultuar 203 përfaqësues të grupeve të interesit për një total prej 369 personash nga të cilët, 196, kanë qenë burra dhe djem.

⁴ FAO (2018): [Forest Policy Document Albania 2030](#)





Figura 5: Paraqitje grafike e pjesëmarrjes së burrave/djemve dhe grave/vajzave në takimet e zhvilluara nga GreenAL




Grafiku 1: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në tryezat e rrumbullakëta e takime të organizuara nga GreenAL

Më në detaj informacione mbi çështjet mjedisore prioritare për OSHC-të dhe institucionet publike i gjeni në Shtojcën 1.

3.1. Fushat prioritare

Duke ju referuar takimeve të zhvilluara me organizatat dhe grupet e interesit në këtë fazë fillestare të projektit e nga ana tjetër duke mbajtur në konsideratë 3 shtyllat tematike të projektit, duke dashur të punojmë paralelisht me objektivat strategjik të vendosura në nivel Evropian, Ballkanik e Kombëtar informacioni i përfutur prej takimeve është sintetizuar si në vijim. Sa i përket pjesëmarrjes në këto tryeza të rrumbullakëta mund të themi se ka pasur një pjesëmarrje të kënaqshme të grupeve të interesit ku

evidentohet pjesëmarrja e 95 OSHC-ve, 33 institucioneve publike dhe 18 ekspertë/aktivistë mjedisor çfarë tregon edhe dëshirën për tu angazhuar në projekte me fokus mjedisin. Në këto takime kanë marrë pjesë rreth 231 persona nga të cilët 129 ose rreth 56% e tyre kanë qenë gra dhe vajza.



Grafiku 2: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në takimet e zhvilluara në rajonet GreenAL

Ndryshimet klimatike

Përprojekjet e GreenAL do të përqendrohen në aktivitete që rrisin kapacitetet e OSHC-ve në monitorimin, analizimin dhe adresimin e ndryshimeve klimatike, si dhe në konsolidimin e rolit të tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërveprimin midis komuniteteve të prekura (me prioritet komunitetet më vulnerabël), aktorëve ekonomikë, vendimmarrësve, dhe subjekteve të kërkimit e inovacionit, në përputhje me qasjen e heliksit të katërfishtë. Qëllimi është të nxitet një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave klimatike, duke adresuar si zbutjen ashtu edhe përshtatjen.

Energjia dhe Dekarbonizimi

- Eficenca energjetike: Përmirësimi i eficiencës energjetike në sektorët rezidencial, social dhe publik; ndërgjegjësimi për reduktimin e konsumit dhe emetimeve; studime mbi skenarët realiste të eficiencës energjetike;
- Varfëria energjetike: Mbështetje për sigurimin e aksesit të barabartë në energji të përballueshme për të gjitha komunitetet, me fokus të veçantë në grupet vulnerabël; Vlerësimi i kostove të enrgjisë elektrike në komunitete dhe kostot sociale;



- Burimet e rinovueshme: Promovimi dhe pilotimi i masave për përdorimin e burimeve të rinovueshme; pilotim i zgjidhjeve bazuar në panele fotovoltaike; studime mbi qëndrueshmërinë e përdorimit të burimeve ujore për energji;
- Dekarbonizimi / Emetimet e CO2 / Tranzicioni energjitik: Reduktimi i emetimeve të karbonit për të arritur neutralitetin klimatik në sektorë/industri të caktuara; studime për të vlerësuar kostot mjedisore dhe kostot/përfitimet e tranzicionit energjitik;
- Kooperativat energjitike: Pilotim i skemave të kooperativave energjitike me bazë komunitetin.

Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike

- Zvogëlimi i riskut ndaj fatkeqësive natyrore: Roli i OSHC-ve në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të fatkeqësive natyrore (Duhet të konsiderohet bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile apo institucione të tjera përgjegjëse)
- Planifikimi adaptiv në nivel lagjeje – qyteti – rajoni: Zhvillimi i planeve për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në nivele të ndryshme administrative; mbështetja e komuniteteve për përballimin e fatkeqësive natyrore në lagje;
- Zgjidhje me bazë natyrën (ZBN) kundër përmblytjeve / efekteve negative të klimës: Përdorimi i ZBN për menaxhimin e përmblytjeve dhe ndikimeve negative të klimës; pilotimi i skemave ZBN për përmirësimin e performancës mjedisore në nivel lagjeje/qyteti
- Vulnerabiliteti i komuniteteve: Vlerësimi dhe hartëzimi i cënueshmërisë së komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike, me fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe gratë; mbështetja e komuniteteve të cënueshme kundrejt fatkeqësive natyrore; krijimi i një rrjeti vullnetarësh për mbështetjen e komuniteteve vulnerabël gjatë ngjarjeve ekstreme të motit.

Zhvillimi Urban, Sektori i ndërtimit dhe Komforti Mjedisor

- Komforti mjedisor, ishujt e nxehjes urbane: Masa dhe udhëzime për uljen e temperaturave të larta në zonat urbane dhe përmirësimin e komfortit mjedisor; studime të ndërvarësisë së komfortit urban me shëndetin publik; vlerësimi i impaktit të gjelbërimit urban si një mënyrë për të luftuar nxehësinë urbane dhe rritur sekuestrimin e karbonit.
- Sektori i ndërtimit: Vëzhgimi, hartëzimi dhe vlerësimi i eficiencës së sektorit të ndërtimit nga pikëpamja energjitike/mjedisore; studime në mbështetje të strategjive afatgjata të rinovimit urban;
- Planifikimi urban: Zhvillimi i udhëzimeve për planifikimin urban që integron konsiderata klimatike; studime mbi ndikimin e zgjerimit të sipërfaqeve të padepërtueshme në ndryshimet klimatike.

Transporti i qëndrueshëm

- Transporti Publik: Promovimi i zgjidhjeve të transportit të qëndrueshëm; udhëzime për reduktimin e emetimeve të CO2 nga sektori i transportit publik; monitorimi i ofrimit të shërbimit të transportit urban në nivel qyteti, bashkie, qarku, kombëtar;



- Mobiliteti: Ndërgjegjësimi për hartimin e planeve të mobilitetit të qëndrueshëm; vlerësimi i efektivitetit të skemave të tranzicionit drejt energjisë së pastër; mbështetja e komuniteteve drejt qarkullimit këmbësor/me biçikleta
- Rrjetet makro-infrastrukturore: Vlerësimi i dekarbonizimit të sektorëve të transportit rrugor, hekurudhor, në përputhje me rekomandimet e Agjendës së Gjelbër
- Monitorimi i shërbimit: monitorimi i ofrimit të shërbimit të transportit urban në nivel qyteti, bashkie, qarku, kombëtar duke marrë në konsideratë edhe emtimet e tyre;

Burimet Natyrore, Sektori i Bujqësisë/Blegtorisë

- Impakti në burimet ujore: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore për të siguruar akses të vazhdueshëm dhe të sigurt në ujë të pastër; studime mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në burimet ujore;
- Bujqësia, blegtoria: Pilotim i praktikave bujqësore e blegtorale të qëndrueshme me emetime të reduktuara karboni; studime mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe sigurinë ushqimore;
- Pyjet: Ndërgjegjësimi për ruajtjen e pyjeve për të absorbuar CO₂; hartëzimi e vlerësimi i fondit pyjor; menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve; studime mbi impaktin dhe kontributin e pyjeve në ndryshimet klimatike; propozimi i praktikave të përfshirjes së komunitetit në mirë menaxhimin e pyjeve.

Kuadri institucional e ligjor, Vendimarrja për klimën, Edukimi Klimatik dhe Inovacioni

- Përmirësimi dhe zbatimi i legjisllacionit mjedisor për të mbështetur qëndrueshmërinë klimatike; ndërgjegjësimi për zbatimin e Planeve të Energjisë e Klimës në nivele të ndryshme; koordinim i aktorëve dhe grupeve të interesit për të vlerësuar kuadrin institucional nga niveli lokal në atë kombëtar;
- Pilotimi i skemave alternative të vendimarrjes në lidhje me klimën (asambletë e klimës);
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve, aktorëve të interesit, sektorit privat, OSHC-ve mbi ndryshimet klimatike, dekarbonizimin, agjendën e gjelbër; bashkëpunimi me institucionet arsimore për të thelluar edukimin mjedisor me praktika në terren; mbështetja për ngritjen e kurrikulave me fokus, ndryshimet klimatike dhe zgjidhjet me bazë natyrën; organizimi i fushatave ndërgjegjësuere në bashkëpunim me aktorët mediatikë.
- Programe trajnimi për OSHC-të dhe institucionet në nivel lokal, rajonal e kombëtar lidhur me shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike;
- Advokimi për ngritjen e platformave digjitale apo përditësimin dhe mirëmbajtjen e tyre lidhur me emetimin e gazeve serrë nga sektorë të ndryshëm.

Kostot Socio-ekonomike e Mjedisore të Ndryshimeve Klimatike

- Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit: Pilotim i vlerësimit me pjesëmarrje të shërbimeve të ekosistemeve natyrore për reduktimin e efekteve klimatike;
- Vlerësimi i kostove socio-ekonomike të tranzicionit energjitik/klimatik në nivele dhe komunitete të ndryshme;



- Vlerësimi i impaktit ekonomik: Studime mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm ekonomikë

Ndotja

Përpyjekjet e GreenAL do të përqendrohen në aktivitete që rrisin kapacitetet e OSHC-ve në monitorimin dhe interpretimin e të dhënave mjedisore, dhe në konsolidimin e pranisë së tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërveprimin midis komuniteteve të ekspozuara, ndotësve dhe vendim-marrësve (si institucionale ashtu edhe jo-institucionale) por edhe më tutje për opinionin dhe publikun e gjerë për të cilin çështja e ndotjes është e një ndjeshmërie të lartë.

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në zonat urbane, industriale dhe pika të nxehta;
- Monitorimi i niveli i zhurmave në zonat urbane dhe ato industriale dhe pika të nxehta;
- Ndotja e tokës në zonat urbane dhe ato rurale me fokus fertiliteti, metalet e rënda, raporti N/C, pesticide, hidrokarburet;
- Ndotja e burimeve ujore: **Uji për njerëzit**, që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve; **Uji për ushqimin**, që përfshin përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit; **Uji për mjedisin**, që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet;
- Gjelberimi urban dhe shërbimet e ekosistemit;
- Mbetjet, ekonomia qarkulluese, ndotja detare; kompostimi në komunitet dhe shkallë;
- Ndotja nga hidrokarburet dhe impakti në shëndetin e komuniteteve dhe natyrë;
- Aksesit tek të dhënat lidhur me ndotjen dhe ndotësit potencial në republikën e Shqipërisë. Popullimi dhe funksionimi i Regjistrit të Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (RTSHN)
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit dhe grupeve të interesit: trajnime të OSHC-ve institucionale; edukimi mjedisor në kurikula; nxitja e praktikave të përfshirjes së komunitetit në monitorim;
- Rishikimi i legjislacionit aktual, strategji, plane, rregullore;
- Kërkimi dhe inovacioni.

Nisur nga koncepti **Mushkëri të Gjelbra** i cili është zbatuar tanimë prej 7 vitesh nga Co-PLAN, do të vijohet dhe thellohet edhe më tepër koncepti monitorimit alternativ të mjedisit. Mushkri të Gjelbra është një nga inisiativat e shoqërisë civile e cila qëndron si burim i vetëm i informacionit lidhur me çështjen e cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmave dhe shërbimet e ekosistemit, me fokus gjelbërimin urban në 5 qytetet kryesore të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër). Raportet vjetore mbi këto komponent si edhe ndërfaqja për të aksesuar monitorimet në nivel lagje e kanë kthyer këtë platformë ndër instrumentet më serioz të ndikimit dhe presionit pozitiv ndaj çështjeve thelbore si ndotja urbane dhe impakti që ai ka në shëndetin publik. Me mbi 300 referime të ndryshme në median e shkruar, vizive dhe radiofonike si dhe në botime shkencore Mushkëri të Gjelbra ka sjell çështjen e cilësisë së ajrit në vëmendjen e qytetarëve dhe politikës në vend.

Fillimisht koncepti i monitorimit alternativ është mbështetur financiarisht nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri për periudhën 2017-2021, më pas u mbështet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) në përmjet fazës së parë të projektit GreenAL 2021-2023. Duke vënë re interesin për të dhënat mbi monitorimin e ndotësve kryesorë të ajrit në qytetet e vendit, kjo metodologji do të vijojë të aplikohet për periudhën 2024-2027 më mbështetjen financiare të Sida nëpërmjet GreenAL.

Aplikimi i kësaj metodologjie gjatë viteve i ka dhënë mundësi disa OSHC-ve si Milieukontakt Albania, Qendra EPER, GO2 Shkodër, Qendra Aarhus Shkodër, Eko-Mjedisi Durrës, Klubi Ekologjik Elbasan të përfshihen në mënyrë aktive në monitorimin e komponentëve mjedisor duke rritur kapacitetet e tyre dhe duke advokuar për politika më të mira në këtë sektor. Nga ana tjetër metodologjia e monitorimit mjedisor mund të themi së ka qenë një risi që është parë e aplikuar me interes edhe në institucionet e arsimit të lartë të tilla si Univeristeti Polis, Universiteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Durrësit dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës duke rritur e edukuar një brez të ri i cili është i ndërgjegjësuar mbi nevojat e monitorimit dhe efektet e ndotjes në shëndetin publik dhe i aftë të advokojë për marrjan e masave për të adresuar problematikën.




Figura 6: Ilustrim i pikave të monitorimit nga platforma digjitale Mushkri të Gjelbra

Raporte vjetore mbi ndotjen e ajrit, zhurmat dhe vlerësimin e shërbimeve të ekosistemit nga gjelbërimi urban publikohen që nga viti 2018. Studime tematike të dedikuara për transportin, ndërtimin, gjelbërimin urban, impaktin e Covid-19, ndotjen në institucionet e arsimit dhe ekspozimin e popullatës ndaj ndotjes, kanë kanalizuar interesin publik për ndotjen e ajrit deri sa ajo u bë një nga temat kryesore gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2021 në Shqipëri. Qëllimi i monitorimit alternativ të ndotjes në mjedis nga OSHC-të apo edhe nga zbatimi i konceptit të “shkencës së qytetarëve” është të ofrojë të dhëna indikative dhe edhe sasiore



mbi ndotjen e ajrit, nivelin e zhurmave në zonat urbane si edhe reduktimin e gjelbërimit urban. Kjo nuk përfshin në asnjë rast përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe metodologjive shkencore pjesë e ligjeve mbi monitorimin e mjedist. Të dhënat e monitorimit alternativ mund të konsiderohen plotësuese në kuadër të gjurmimit dhe interpertimit të faktorëve ndotës në zonat urbane për të influencuar në procese të ndërgjegjësimit dhe vendimarrjes. Çdo nevojë për interpretim ligjor të nivelit të ndotjes do të kërkojë angazhimin e laboratorëve të certifikuar me pajisje dhe personel të akredituar konform rregullave dhe procedurave në fuqi nga Drejtoria Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri.

Kjo inisiativë zbaton një metodologji alternative të ndërtuar nga vetë autori duke u bazuar në sektorët me shkarkimet më të mëdha si transporti, industria, zhvillimi urban ku mat specifikisht PM10, PM2.5, CO, CO2, SO2, NO2, C6H6 dhe VOC, zhurmat në kontekstin urban sikundër edhe gjelbërimit urban për të llogartitur më tutje shërbimet në ekosistem.

Natyra

Përpyekjet e GreenAL do të përqendrohen në aktivitete që rrisin kapacitetet e OSHC-ve në tematika që cilat ngrenë dhe adresojnë çështje të cilat prekin, burimet natyrore, natyrën dhe biodiversitetin për të rritur ndërgjegjësimin e ndërveprimin ndërmjet komuniteteve lokale dhe vendim-marrësve (si institucionale ashtu edhe jo-institucionale), por edhe për publikun e gjerë për të cilët çështjet e natyrës dhe biodiversitetit janë të rëndësishme, duke qenë se natyra nuk njih kufi administrativ.

- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit: Permirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura, parqet dhe rezervatet kombëtare duke përfshirë edhe ato detare;
- Restaurimi i ekosistemit: pyllëzime dhe ripyllëzime; restaurimi i ligatinave për të përmirësuar cilësinë e ujit biodiversitetin dhe reduktuar përmytjet;
- Ekosistemet bregdetare dhe detare, mbrojtja dhe promovimi;
- Menaxhimi i qendrushëm i tokës: parandalimi i erozionit dhe rëshqitjeve;
- Menaxhimi i baseneve ujore, përfshirë zonat riparjane (buferike);
- Mbrojtja e ligatinave si element për ruajtjen e cilësisë së ujit dhe biodiversitetit;
- Identifikimi dhe ngritja e rrjetit “Natyra 2000”;
- Menaxhimi i qendrushëm i pyjeve dhe promovimi i praktikave të mira për pëfshirjen e komunitetit;
- Krimi mjedisor, gjuetia e paligjshme, prerja e pyjeve, zjarret në pyje dhe zona të mbrojtura;
- Praktika të mira për parandalimin e zjarreve në pyje dhe zona të mbrojtura;
- Monitorimi i zhvillimit urban në zona e mbrojtura;
- Monitorimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore;
- Rishikimi i legjislacionit aktual, strategji, plane, rregullore;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit dhe grupeve të interes: trajnime të OSHC-ve institucioneve; edukimi mjedisor në kurikula; nxitja e praktikave të përfshirjes së komunitetit në monitorim;
- Monitorimit dhe vlerësimit të statusit për habitatet dhe speciet me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare;



- Identifikimi dhe dokumentimi i praktikave komunitare për menaxhimin e burimeve të përbashkëta në territorin e Shqipërisë. Rasti i Krahinës së Radomirës në Bashkinë Dibër, në të cilën pyjet menaxhohen nga këshilli i kryepleqve të 5 fshatrave të asaj zone;
- Identifikimi i specieve invazive të florës dhe faunës në zonat e mbrojtura dhe vlerësimi i impaktit të tyre në ekuilibrin e këtyre ekosistemeve në një periudhë afatshkurtër dhe në aftatgjatë;
- Vlerësimi i popullatës së specieve në rrezik zhdukjeje në territorin e Shqipërisë bazuar në librin e kuq të florës dhe faunës;
- Hartëzimi i itinerarëve të shpendëve migratore në territorin e Shqipërisë dhe faktorizimi i këtyre itinerarëve në harta/databaza publike globale (fokus i veçant për specie në rrezik). Hartëzimi i itinerarëve do të ndihmonte ekspertët e fushës por edhe qytetarët të kuptonin vlerën e biodiversitetit si dhe lidhjen me vendet europiane, ballkanike pse jo edhe më gjerë;
- Identifikimi dhe krijimi i aktiviteteve turistike që valorizojnë vlerat e natyrës dhe biodiversitetit në zonat e mbrojtura me impakt minimal në mjedis. (itinerare këmbësore, vëzhgim shpendësh, piknik, peshkim sportiv, shëtitje me varka jo-motorrike, etj);
- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës turistik të zonave të mbrojtura dhe monumenteve natyrore për të zvogëluar impaktin e turizmit masiv dhe për të menaxhur më mirë fluksin turistik;
- Vlerësimi i shëndetit të masivit pyjor në territorin e Shqipërisë dhe propozimi i masave për përmirësimin e gjendjes;
- Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit në zonat e mbrojtura për të nxjerrë në pah përfitimet e shoqërisë nga ekzistenca e tyre (bashkëpunim me aktorë të ndryshëm në nivel lokal, rajonal e kombëtar).

3.2. Takime me institucionet publike

Një nga grupet kryesore të interes për GreenAL janë edhe institucionet publike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar duke qenë se referuar legjislacionit në fuqi janë ato të cilat hartojnë dhe monitorojnë zbatimin e politikave në varësi të kompetencave të tyre në territorin e vendit. Kapacitetet e këtyre institucioneve në disa raste nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet ligjore apo për të zbatuar fushata ndërgjegjësuese për komunitetin e për këtë arsye OSHC-të mund të shërbejnë për të asistuar këto institucione në rritjen e kapaciteteve dhe ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese me qëllimin final adresimin e problematikave mjedisore.

Bashkitë/njësitë e qeverisjes vendore shërbejnë si institucionet parësore që ofrojnë shërbime lokale dhe janë pika fillestare e kontaktit për qytetarët që kërkojnë informacion mbi ofrimin e shërbimeve apo çështjet mjedisore. Përveç këtij konteksti, legjislacioni përkatës, veçanërisht ligji 139 'Për vetëqeverisjen lokale', u cakton bashkive një sërë përgjegjësish dhe detyrimesh. Nga ana tjetër, bashkitë ngarkohen me detyrime të diktuar nga ligje të tjera sektoriale, të cilat shpesh tejkalojnë kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore të bashkive, duke e bërë sfiduese përmbushjen e plotë të këtyre detyrimeve. Në këtë drejtim, OSHC-të mund të mbështesin bashkitë në përmbushjen e disa prej këtyre detyrimeve, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve, asistencë në hartimin e dokumentave të cilat do të kishin impakt në mirë menaxhimin e mjedisit, fushatat ndërgjegjësuese të cilat targetojnë komunitetin, procese të cilat rrisin transparencën dhe gjithpërfshirjen në vendim-marrje duke lehtësuar përfshirjen aktive të OSHC-ve dhe




komuniteteve. Duke lehtësuar një mbështetje të tillë, ne synojmë të nxisim bashkëpunimin produktiv dhe të krijojmë bazat për bashkëpunim afatgjatë ndërmjet OSHC-ve, komuniteteve dhe bashkive.

Këshillat dhe Këshilltarët Bashkiakë, të cilët shërbejnë si niveli më i lartë i vendimmarrjes në nivel vendor. Këta përfaqësues luajnë një rol vendimtar në mbështetjen dhe miratimin e nismave dhe metodologjive të paraqitura gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Për më tepër, këshillat bashkiak janë përgjegjës për monitorimin e funksionimit të bashkisë. Si përfaqësues të komunitetit, ata kanë autoritetin të kërkojnë veprime për çështjet mjedisore brenda territorit të bashkisë. Për këtë arsye, angazhimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak është thelbësor për marrjen e mbështetjes, miratimit dhe avokimit për iniciativat mjedisore dhe adresimin efektiv të shqetësimeve mjedisore lokale.

Institucione të tjera të cilat operojnë në nivel rajonal, si Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (institucionet e përmendura këtu janë vendosur si shembuj, lista nuk është shteruese). Këto institucione luajnë rol të rëndësishëm në sektorin e mjedisit dhe shpesh përfshihen në projekte të udhëhequra nga OSHC-të. Përfshirja e përfaqësuesve nga këto institucione rajonale në diskutime mund të përmirësojë bashkëpunimin, të ndajë burimet dhe të shfrytëzojë ekspertizën për të trajtuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore. Për më tepër, përfshirja e tyre mund të ndihmojë në sigurimin e përafrimit me prioritetet dhe rregulloret rajonale, duke kontribuar në suksesin e përgjithshëm dhe qëndrueshmërinë e nismave të ndërmarra nga OSHC-të në nivel lokal.

Janë zhvilluar deri më tani 48 takime me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal, rajonal e kombëtar të tilla si: Instituti i Shëndetit Publik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Administrata e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore Arsimore, Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencitë Rajonale të Mjedisit. Takimet me institucionet shërbyen për ti njohur përfaqësuesit e tyre me programin dhe mundësitë potenciale të bashkëpunimit me OSHC-të mjedisore të cilët janë edhe fokusi kryesor i programit. Në total janë takuar 138 persona ku 77 ose 56% e tyre kanë qenë gra dhe vajza.

Nga ana tjetër këto takime shërbyen edhe për të marrë indicie mbi çështje mjedisore apo aktivitete ndërgjegjësuere të cilat këto institucione mund ti adresojnë me asistencën e OSHC-ve si një mënyrë e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe fokusuar lidhjet ndërmjet institucioneve-OSHC-ve-komunitetit.



Grafiku 3: Pjesëmarrja e grupeve të interesit në takimet e zhvilluara në rajonet GreenAL

Në përfundim të takimeve të zhvilluara më përfaqësues të këtyre institucioneve në disa rajone të vendit më posht paraqiten disa fusha apo sektorë në të cilat OSHC-të mund të asistojnë këto institucione. Më tepër mbi fushat potenciale të bashkëpunimit për çdo institucion të konsultuar do të gjeni në Shtojcën 1.




Figura 7: Ilustrim grafik i grupeve të interesit të kontaktuar nga Partnerët GreenAL



Kujdes! Bashkëpunimi me institucionet duhet të shërbejë në rritjen e kapaciteteve, ndërgjegjësimin e komunitetit apo grupeve të interesit, ngritjen dhe konsolidimin e marrëdhënies më OSHC-të dhe komunitetin, monitorimin e komponentëve mjedisorë dhe asistencë në bashkë-hartimin e planeve apo strategjive të cilat këto institucione nuk kanë kapacitete (mungesë e provuar kapacitetesh) për ti përmbushur të vetme.

- Mungesa e planeve të cilësisë së ajrit dhe menaxhimit të zhurmës;
- Mungesa e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe zhurmave;
- Menaxhimi i mbetjeve, infrastruktura, kompostimi, ekonomia qarkulluese ndërgjegjësimi;
- Aplikimii parimeve të ekonomisë qarkulluese reduktimi i paketimeve njëpërdorimshe;
- Ndotja nga plastika me fokus burimet ujore dhe detin;
- Menaxhimi i pyjeve, hartimi i planeve, monitorimi, masa për parandalimin e zjarreve, përfshirja e komunitetit në mirëmbajtje;
- Ndotja në burimet ujore, tokë dhe ajër nga industria e përpunimit të hidrokarbureve dhe mineraleve;
- Erozioni dhe rëshkitjet në disa territore të bashkive;
- Studim mbi vlerësimin impaktit të erozionit detar;
- Mungesa e infrastrukturës për grumbullimin transportin dhe trajtimin e ujrave të ndotur urban;
- Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit në zonën urbane dhe atë natyrore;
- Ndotja e tokës bujqësore nga përdorimi i ushqyesve dhe pesticideve në proceset bujqësore;
- Përfshirja e universiteteve në procese monitorimi, ndërgjegjësimi, dhe kapacitimi;
- Vlerësimi i impaktit në mjedis dhe shëndet të ish zonave industriale;
- Nevoja për trajnime në shkrimin e projekt propozimeve dhe në çështjet mjedisore;
- Ndërgjegjesimi i komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me çështjet kryesore mjedisore.

3.3. Çështje të tjera për tu mbajtur në konsideratë

GreenAL synon evidentimin dhe adresimin e çështjeve mjedisore dhe për këtë arsye kërkon të mbështesë OSHC të cilat kanë eksperiencë në sektorin e mjedisit me synim adresimin e tyre në mënyrë efektive. Nga ana tjetër Partnerët GreenAL janë të vetëdijshëm që komponenti mjedisor është një nga elementët e zhvillimit të shoqërisë dhe që ai të adresohet në mënyrë të qënësishme në konsideratë duhet të merren edhe faktorët ekonomik e social të një komuniteti, apo territori në të cilin do të zbatohet projekti. Në këtë drejtim çështje të cilat mund të adresohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthore janë edhe aspektet social-ekonomike të komuniteteve, të rinjve, grave apo grupeve vulnerabël, të lidhura këto gjithnjë me objektivin kryesor, çështjet mjedisore. Në këtë drejtim përgjat fazës së reflektimit mbi ngjitjen e partneriteteve apo hartimit të projekteve mund të merren në konsideratë aspekte të cilat lidhen me efektet e ndryshimeve klimatike, ndotjes, natyrës të cilat impaktojnë komunitet në aspektin social-ekonomik duke konsideruar angazhimin e OSHC me fokus çështjet gjinore, të rinjtë, grupet vulnerabël etj.

Vlerësohen aktivitete të cilat nxisin:



- pjesëmarrjen e komunitetit duke lehtësuar përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrëse për të siguruar që programet të pasqyrojnë nevojat dhe dëshirat e komunitetit;
- programet e liderimit rinor, zbatimi i aktiviteteve që nxisin aftësitë e liderimit tek të rinjtë dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në iniciativat e komunitetit me fokus çështjet mjedisore;
- përfshirjen në procesin dhe dialogun me politikë-bërësit lokal/rajonal/kombëtar, ndër-rajonal (Ballkanin Perëndimor)
- bashkëpunimin ndërinstitucional (ndërmjet bashkive, agjensive, ministrive) ku në fokus janë komunitetet dhe OSHC-të. Vlerësohet bashkëpunimi i institucionalizuar nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit apo formave të tjera marrëveshjeve ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve.
- bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve në formën e rrjeteve, grupeve apo në forma të tjera për të advokuar për politika më të mira në sektorin e mjedisit;
- hartimin e dokumentave të cilat ofrojnë këndvështrimin alternativ të OSHC-ve për zhvillimet në sektorin e mjedisit (raporte, artikuj shkencor, letra pozicionimi);
- fushata promovuese, zhvillimi i fushatave gjithëpërfshirëse promovuese duke përdorur një kombinim të mediave tradicionale (radio, TV) dhe platformave dixhitale (media sociale, faqet e internetit);
- aktivitete edukuese, zbatimi i programeve/moduleve/aktiviteteve informuese në shkolla dhe universitete për të nxitur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen tek të rinjtë. Zhvillimi i aktiviteteve ku të rinjtë mund të angazhohen dhe përftojnë njohuri duke kombinuar teorinë dhe praktikën;
- trajnime/konferenca/puntori, të cilat mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe dijeve ndërmjet grupeve të interesit;
- tregimi i historive dhe dëshmive nga pjesëmarrësit, mbledhni dhe ndani histori, dëshmi nga grupet e interesit të cilët kanë qenë të përfshirë në projekt dhe/ose kanë qenë përfitues të tij, për të theksuar ndikimin e projekteve dhe për të frymëzuar të tjerët (historitë të dokumentuara me video);
- monitorimin në terren duke përfshirë në mënyrë aktive qytetarët dhe studentët/nxënësit;

3.4. Integrimi i Perspektivës Gjinore në projektet Mjedisore

Ndryshimet klimatike kombinuar me problemet mjedisore dhe sociale përbëjnë sfida dhe ushtrojnë presion mbi sigurimin e ujit dhe ushqimit, energjinë elektrike, stabilitetin financiar, burimet natyrore dhe shëndetin e përgjithshëm të popullsisë. Në pamje të parë duket sikur marrëdhënia ndërmjet mjedisit fizikë dhe shoqërisë është neutral nga pikëpamja e gjinisë, pra burrat dhe gratë ndikohen në mënyrë të barabartë, por nga një vështrim më i afërt do të kuptonim që ndikimi nuk është i barabartë. Përkundrazi, si rezultat i barrierave social-ekonomike, politike dhe ligjore, gratë ndikohen më shumë se burrat nga ndryshimet klimatike dhe përkeqësimi i mjedisit, në këtë drejtim edhe Shqipëria nuk është rast përjashtimorë. Disa shembuj të barrierave të cilat bëjnë që gratë të ndikohen ndryshe janë: akses i limituar në burime financiare dhe paga më të ulta si rezultat i faktit se përqindja e grave të punësuar është më e ulët krahasimisht me burrat, gratë mbajnë pozicione të ulta pune dhe përqindja e grave të punësuar në tregun informal është më e lartë. Më shumë punë për kujdesëse të papaguar krahasimisht me burrat që i pengon gratë t'ja kushtojnë këtë kohë aktiviteteve të tjera që mund të jenë të paguara ose jo, ose thjesht



për të pushuar. Mungesë e aksesit ndaj teknologjisë dhe burimeve për të rritur kapacitetet si rezultat i mungesës së kohës për të mësuar, mundësive financiare më të pakta, etj.

Nisur nga këto premisa GreenAL, ka marrë iniciativën të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e integritit të perspektivës gjinore në projektet mjedisore, duke angazhuar një ekspert gjinorë për qëllime të projektit, e cila mbështet dhe do të suportojë çdo përpjekje nga ana e OMSHC-ve (të integrojnë perspektivën gjinore në konceptim, shkrim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të projektit) me qëllim avancimin e barazisë gjinore në fushën e mjedisit. Thënë ndryshe, mirëpritet çdo përpjekje e organizatave mjedisore që të vlerësojnë përfshirjen e grave, burrave, vajzave dhe djemëve në çdo veprim të planifikuar të projektit përpara se të merret një vendim. Duke i bërë kështu nevojat, prioritetet dhe eksperiencat e burrave dhe grave pjesë e projekteve mjedisore në të gjitha hapat e tyre.

Si rezultat i karakteristikave të tilla si: seksi, gjinia, moshë, etniciteti, zona ku jetojmë, orientimi seksual, aftësia e kufizuar në jemi të ndryshëm për këtë arsye edhe nevojat, prioritetet dhe eksperiencat tona janë të ndryshme. Me qëllim identifikim e këtyre nevojave, prioriteteve dhe eksperiencave të burrave dhe grave në një kontekst të caktuar dhe integrimin e tyre në projekt, ju vjen në ndihmë analiza gjinore ose “studimi i kontekstit”.

Analiza gjinore: thekson diferencat ndërmjet dhe midis grave dhe burrave, shpërndarjen e burimeve (të cilat mund të jenë financiare, natyrore, etj), mundësive (për të marrë pjesë, pëfituar dhe përfshirë në terma të barabartë), kufizimeve (të cilat mund të jenë ligjore ose socio-kulturore: besimi se gratë nuk mund të jenë peshkatore, fermere, sipërmarrëse të mira, ligje diskriminuese ndaj grave, etj) dhe pushtetit (se kush merr vendimet) në një kontekst të caktuar.

Si mund të kryeni një analizë gjinore?

Është mirë që analizën gjinore ta kryeni para se të shkruani projektin, pasi kështu keni mundësi që të adresoni pabarazitë gjinore në fushën ku ju doni të punoni.

Hapi i parë për të bërë një analizë gjinore, në bazë të problematikës që ju do të adresoni, është të lexoni raporte, studime të mëparshme⁵, vlerësime, statistika⁶, politika të cilat adresojnë marrëdhënien midis burrave dhe grave në termat e :

Roleve gjinore dhe ndarjes së punës. Cilat janë rolet dhe përgjegjësit e grave dhe burrave? Si ndërveprojnë? Çfarë ata bëjnë, çfarë ata mund të bëjnë, çfarë pritet nga shoqëria që të bëjnë? Gratë dhe burrat përmbushin role të ndryshme në shtëpi, në shkollë, në vendin e punës, në komunitet, në nivel qeveritar. Kështu, burrat janë të angazhuar në punë të cilat ndodhin kryesisht jashtë shtëpisë dhe gjenerojnë të ardhura financiare apo burime të tjera ekonomike. Ndërkohë, gratë janë më të angazhuara në punët e shtëpisë, duke u kujdesur për fëmijët, të moshuarit, gatimin dhe pastrimin. Gratë janë

⁵ Këtu i referohemi analizave gjinore që mund të jenë bërë më parë dhe UNËOMEN është një burim shumë i mirë informacioni. <https://albania.unwomen.org/en>

⁶ Burimi më i mirë për të gjetur statistikat të ndara në bazë të seksit/gjinisë është INSTAT: Instituti i Statistikave. <https://ëëë.instat.gov.al/>



përgjithësisht përgjegjëse për punë të cilat nuk sjellin të ardhura dhe që reflektohet në shpërndarjen e pabarabartë të punës së papaguar midis burrave dhe grave.

Akses dhe kontroll mbi shërbimet dhe burimet: A kanë burrat dhe gratë akses të barabartë tek burimet e nevojshme? Cilat janë barrierat gjinore që limitojnë aksesin në burime? Kur flasim për burime flasim për mjete dhe të mira, duke përfshirë shërbime bazë si (arsimim, shëndetësi), burimet ekonomike (të ardhurat familjare), burime të tjera si toka, paisje, shërbime financiare dhe koha, etj. Akses në burime kuptojmë që burrat dhe gratë janë në gjendje ti përdorin dhe përfitojnë prej tyre. Kontroll mbi burimet do të thotë që jo vetëm janë në gjendje ti përdorin dhe përfitojnë por edhe të marrin vendim sesi ta përdorin atë. Si p.sh: të ardhurat familjare.

Pjesëmarrja publike dhe vendimmarrja: A kanë gratë dhe burrat të drejta, mundësi dhe kapacitete për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në vendimmarrje (në familje, shoqëri, politik, ekonomi)? A dëgjohet zëri i grave dhe burrat në mënyrë të barabartë? Pabarazi gjinore ekzistojnë në pjesëmarrje dhe vendimmarrje në familje, në nivel komuniteti, në politik dhe ekonomi dhe në shoqëri në përgjithësi. Gratë dhe minoritetet (persona me aftësi të kufizuara, komuniteti romë, egjiptian, LGBT, etj.) shpesh janë të nënpërfaqësuar në organet vendimmarrëse, veçanërisht në shoqërinë civile dhe politik. Kjo do të thotë se ata kanë pak ndikim në shpërndarjen e mjeteve dhe përcaktimin e agjendës politike. Megjithatë, pjesëmarrja e grave nuk shoqërohet automatikisht me rritjen e fuqisë vendimmarrëse për gratë. Pjesëmarrja e barabartë kërkon përfaqësim të barabartë (numra) dhe kapacitet dhe fuqi për të pasur ndikim.

Nevojat dhe interesat e burrave dhe grave. Cilat nevoja gjinore (të grave dhe burrave lidhen direkt me projektin tuaj? Cilat nevoja janë specifike për kontekstin? Kur flasim për nevojat e burrave dhe grave flasim për nevoja të cilat e bëjnë jetën e përditëshme më të lehtë për burrat dhe gratë dhe i mundëson atyre të përfshihen në aktivitete fitimprurëse apo rritje kapacitetesh (si.p.sh: akses në uji, transport më i mirë, institucione përkujdesëse për fëmijët).

Hapi i dytë: Në momentin që ju ndjeni se ka mungesë informacioni për problematikën që ju doni të adresoni atëherë ndërmerri analizën tuaj gjinore. Kjo mund të ndërmerret duke organizuar fokus grupe, ëorkshope me burra dhe gra të komunitetit ku ju do të zbatoni projektin tuaj, duke shpërndarë pyetësor me anë të cilit mund të mblidhni të dhëna sasiore (shifra/përqindje) ose të dhëna cilësore (eksperienca, nevoja, histori).

Hapi i tretë: Integrimi i gjetjeve në projektin tuaj. Në bazë të gjetjeve dhe pabarazive të identifikuara midis dhe ndërmjet grave dhe burrave ju ta integroni perspektivën gjinore në këto mënyra:

1. Objektiva, rezultate dhe aktivitete të cilat adresojnë barazinë gjinore;

Disa nga pyetjet që mund të bëni dhe mund t'ju ndihmojnë juve që të keni objektiva, rezultate dhe aktivitete të cilat promovojnë barazinë gjinore janë: A është e nevojshme që të kemi objektiva specific lidhur me gjininë? A janë përfshirë pabarazitë gjinore në analizën e logframe ose riskut. A është e mundur të kemi indikator të ndarë për burrat dhe gratë? Analiza e riskut, a merr në konsideratë barriera që mund të pengojnë pjesëmarrjen e grave dhe burrave në aktivitete sikundër mund të jetë (mungesa e kohës, transporti, mjetet financiare, etj) dhe propozoni masa për të ulur riskun.



2. Stafi i manaxhimit të projektit është sensitivë ndaj çështjeve gjinore:

Disa nga pyetjet që mund të adresoni për tu siguruar që stafi juaj është sensitivë ndaj çështjeve gjinore: A është stafi i projektit familjar me çështjet gjinore në përgjithësi, pasi stafi do të zbatojë aktivitetet? A është i nevojshëm trajnim në lidhje me çështjet gjinore për stafin? Cila është përbërja e stafit (burra/gra). A u është dhënë mundësia në mënyrë të barabartë grave dhe burrave që të përfshihen në pozicione drejtuese dhe specifike?

3. Bashkëpunëtorët potencial janë të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore:

Disa nga pyetjet që mund t'ju ndihmojnë për tu siguruar që bashkëpunëtorët tuaj janë të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore janë: Cilat janë kapacitetet e institucioneve apo organizatave partnere për të përfshirë një perspektivë gjinore në punën e tyre dhe promovuar përfshirjen e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë në të gjitha nivelet? A është i nevojshëm një trajnim mbi gjininë dhe mjedisin midis partnerëve potencial? A është e nevojshme të përfshihen palë të treta/ ekspert të jashtëm për tu siguruar që projekti është i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore?

4. Indikator të ndjeshëm gjinorë për monitorim dhe vlerësim:

Disa nga pyetjet që do t'ju ndihmonin të formuloni indikator të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore janë: A janë identifikuar indikator specifik për të monitoruar rezultatet lidhur me barazinë gjinore? Në projektet me bazë komunitare a janë përfshirë në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë në përgatitjen e indikatorëve?

Shembuj të rezultateve dhe indikatorëve: Energji e qëndrueshme.

Vini re: Ky është thjesht një shembull ilustrues dhe nuk i referohet asnjë projekti specifik!!!

Shembuj të rezultateve	Shembuj të indikatorëve
Eshtë rritur aksesimi i grave në teknologji elektrike (pajisje, makineri, etj) të cilat kursejnë kohë, janë të përballueshme, punojnë me energji të rinovueshme dhe nuk ndotin ambientin? Eshtë rritur efënca energjitike për familje.	<ul style="list-style-type: none">- Numri i trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese që targeton gratë dhe burrat mbi efëncën energjitike, sigurinë, kursimin dhe numëri i grave dhe burrave pjesëmarrës.- Sa të kënaqur janë gratë dhe burrat me pajisjet elektrike ose teknologji që punojnë me energji të rinovueshme (përballueshmëria, siguria, efënca, arsyeja e mosblerjes së paisjeve apo teknologjive të reja.
Eshtë arritur targeti i grave të punësuar si ofruese dhe teknike/inxhinierë të energjisë së rinovueshme.	<ul style="list-style-type: none">- Numri ose përqindja e grave dhe burrave të cilët u trajnuan sesi të ngrenë, përdorin, mbajnë ose menaxhojnë biznese energjie të vogëla ose të mesme.- Numri ose përqindja e grave dhe burrave të cilët fitojnë të ardhura si ofrues të energjisë së rinovueshme dhe inxhinier/e ose teknike/teknike bazuar në llojin e



	teknologjisë elektrike (diellor, biogaz).
Eshtë rritur ndërgjegjësimi i ofruesve të shërbimit mbi çështjet gjinore në sektorin e energjisë.	<ul style="list-style-type: none">- Numri i trajnimeve dhe sesioneve ndërgjegjësuese të mbajtura me bordin e energjisë, agjensitë, dhe ofruesit e shërbimit në lidhje me çështjet gjinore në fushën e energjisë.- Numri dhe përqindja e burrave dhe grave të cilët kanë ndjekur trajnime mbi çështjet gjinore (sipas agjensisë dhe llojit të punëdhënësit).

Ndërkohë që zhvilloni projektin tuaj, do të ishte mirë të kishit parasysh këto elemente: Barazia gjinore është garantuar në të gjitha aktivitetet e projektit (bëjnë përjashtim rastet kur projekti juaj është i fokusuar vetëm tek burrat ose gratë). Lidhja ndërmjet gjinisë dhe çështjeve të ndryshme mjedisore është një pikë diskutimi në takime, ëorkshope, konferenca, etj. Në raporte, fjalime është përdorur një gjuhë e ndjeshme ndaj gjinisë. Zhvilloni strategji komunikimi të cilat i japin mundësi të gjithëve të informohen mbi projektin. Të dhënat e mbledhura janë të ndara në bazë të seksit dhe gjinisë.

3.5. Bashkëpunimi me OSHC e rrjete rajonale

Vendet e BP konsiderohen si ekonomi me të ardhura të mesme-të larta të karakterizuara kryesisht nga ekonomi të vogla e të hapura me një tregti në rritje ku rreth 73% e exportit të këtyre vendeve shkojnë drejt vendeve të BE dhe 68% e importit të produkteve vjen nga vende të BE⁷. Të dhëna këto të cilat tregojnë për një marrëdhënie tregtie të konsoliduar ndërmjet vendeve të Be dhe BP e cila me gjasë do të intensifikohet e rritet në vitet e ardhshme. Në mbështetje të politikave të zgjerimit në Nëntor të 2023 BE shpalli një plan të rritjes për vendet e BP me qëllim mundësimin e përsheptimit të ndërmarjes së reformave dhe kryerjes së investimeve të nevojshme të cilat do të mundësonin antarësimin e vendeve të BP në BE.

Megjithatë, në prani të sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike si dhe të një historiku jo fort të mirë të bashkëpunimit rajonal, kërkohet përfshirja e të gjithë aktorëve për të vendosur themelet për një rritje të gjelbër e me aftësi ripërtëritëse.

Integrimi i vendeve të BP në BE kalon në disa faza, ndër to është edhe adresimi i çështjeve emergjente mjedisore, të cilat janë të ngjashme në të gjitha vendet e BP.

Në këtë drejtim duke ditur se sfidat mjedisore nuk njohin kufij territorial e janë tepër komplekse për tu adresuar në mënyrë të fragmentuar pasi impaktojnë komunitetet në forma të ndryshme OSHC-të mund të luajnë një rol shumë kryesor për të lehtësuar procesin hartimit dhe zbatimit të politikave të reja të cilat kanë në fokus mbrojtjen e mjedisit.

⁷ Western Balkans 6, Country Climate Development Report, World Bank Group, June 2024.



Disa nga sfidat mjedisore me të cilat përballen vendet e BP janë paraqitur në mënyrë jo shteruese më poshtë:

- Zbutja e ndikimit dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike;
- Ruajtja e biodiversitetit, mbrojtja e ekosistemeve unike, specieve të rrezikuara dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokës;
- Cilësia e ajrit dhe ujit;
- Aplikimit të parimeve të ekonomisë qarkulluese për të promovuar përdorimin efikas të burimeve, reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre;
- Qëndrueshmëria Urbane si shkak i rritjes së urbanizimit;
- Drejtësia Mjedisore, për ti dhënë akses të barabartë në burime komuniteteve të ndryshme me fokus kryesor komunitetet e marginalizuara;
- Promovimi i bashkëpunimi ndërkufitar, duke qënë se lumenjtë e ekosistemet nuk njohin kufinj administrativ.

Duke parë dhe bashkëpunuar me disa organizata në BP, Partnerët GreenAL, vërejnë se ka disa projekte të ngjasme të cilat kanë në fokus të tyre forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe advokimin për politika më të mira mjedisore në përputhje me objektivat e Agjendës së Gjellbërt Europiane.

Në këtë drejtim, Partnerët GreenAL, inkurajojnë OSHC-të të cilat janë të interesuara për të aplikuar në skemat e granteve në këtë projekt të marrin në konsideratë krijimin e sinergjive potenciale me organizata të tjera në BP të cilat adresojnë problematika apo operojnë në fusha të ngjashme. Krijimi i sinergjive potenciale me organizata apo rrjete të cilat kanë në fokus çështjet mjedisore, kryesisht e sugjeruar për aplikantët në thirrjen për grantet tematike e rajonale, do të ndihmonte në rritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e provojave e praktikave të mira si dhe lehtësimin e përfshirjes së organizatave Shqiptare në rrjete Rajonale apo Europiane.

Për të lehtësuar këtë proces si dhe për të ofruar disa pika reference, Partnerët GreenAL, kanë zhvilluar një proces hartëzimi të organizatave të cilat operojnë në fushën e mjedisit në BP të cilat janë pasqyruar në Shtojcën 2.

3.6. Përafrimi me qëllimet e projektit

GreenAL kërkon të rrisë praninë dhe presionin pozitiv të OSHC-ve gjatë proceseve politkbërëse duke përfshirë këtu negociatat për integrimin në BE, tranzicionin e gjellbërt dhe Kapitullin 27 si përfaqësues i interesave të qytetarëve, mbajtës i njohurive kritike të domosdoshme duke qënë kështu një partner i besueshëm i institucioneve gjatë reformave për zhvillimin dhe progresin e vendit drejt BE-së.

Me anë të monitorimeve që do të kryhen në nivel kombëtar dhe çështjeve që do të ngrihen nga OSHC-të përfituese të skemës së granteve, GreenAL synon të nxisë diskutimin dhe të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet komunitetit dhe institucioneve për të marrë masat e nevojshme dhe bashkërenduar forcat në adresimin e sfidave të cilat vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike, ndotjes, shfrytëzimit të burimeve.



Figura 8: Ilustrim grafik i çështjeve mjedisore në fokus të GreenAL

Aktivitetet kryesore GreenAL

Përtej mbështetjes financiare në formën e granteve Partnerët GreenAL do të organizojnë disa aktivitete dhe do të gjenerojnë disa produkte të cilat do ti japin mundësi të gjithë përfituesve të granteve dhe organizatave partnere të faktorizojnë punën e tyre të lidhur me çështjet mjedisore, angazhimin komunitar, advokimin etj. si një përpjekje e unifikuar për të përmbushur pritshmëritë që komunitetet dhe institucionet shtetërore kanë ndaj OSHC-ve. Partnerët GreenAL mendojnë dhe besojnë se të vetëm mund të jemi aktor në proceset politikkbërëse, por të bashkuar si një grup i vetëm mund të jemi përcaktues në proceset e ardhshme me fokus kryesor adresimin e sfidave mjedisore dhe Integrimin në BE

Në këtë drejtim disa aktivitetet të cilat OSHC-të e interesuar për të aplikuar në GreenAL mund të kenë interes për të bashkëpunuar dhe/ose kontribuar paraqiten më poshtë:

- **Krijimi i Rrjetit GreenAL**, përfituesit e granteve GreenAL por edhe OSHC të tjera të cilat kanë dëshirë të bëhen pjesë e këtij rrjeti do të mund të bëhen duke firmosur një Memorandum Bashkëpunimi.



- **Organizimi i fushatave kombëtare** me fokus çështjet emergjente mjedisore, ndryshimet legjislativë në sektorin e mjedisit, nevojat e komuniteteve. Tematikat e fushatave do të dakordësohen me Rrjetin dhe/ose do të përgjigjen një çështje mjedisore emergjente. Në fokus do të jetë organizimi i fushatave me qëllim advokimin për çështjet mjedisore përpara zgjedhjeve vendore dhe kombëtare të ardhshme.
- **Organizimi i Forumeve tematike mjedisore** të cilat ngrenë një çështje mjedisore me impakt rajonal apo kombëtar;
- **Hartimi i raportit vjetor** të mbi procesin e Integritimit në BE me fokus Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik, Ndërlidhjen dhe Rritjen e Gjelbërt.
- Pjesëmarrje në procesin e **inkubimit** (trajtimeve tematike) të cilat do të zhvillohen në rajonet GreenAL me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe ndarjen e praktikave të mira ndërmjet OSHC-ve, ekspertëve mjedisor, aktivistëve dhe përfaqësuesve të institucioneve në nivel lokal, rajonal e kombëtar.
- **Promovimi i projekteve dhe praktikave të mira** të zbatuara nga pjestarët e Rrjetit GreenAL. Faqa e internetit të GreenAL do të shërbejë si një platformë për të promovuar punën e OSHC-vë, publikimin e artikujve me fokus mjedisin, problematika mjedisore të cilat prekin komunitetet të ndryshme në territorin e vendit. Shpërndarja dhe promovimi i projekteve/praktikave do të ndihmojë në rritjen e bazës së qytetarëve të arritur.

3.7. Thirrja për grante

Skema e granteve është ideuar duke pasur në vëmendje kombinimin e qasjes nga poshtë-lartë dhe nga lartë-poshtë, duke mbajtur në konsideratë nevojat e OSHC-ve në vend si dhe problematikat mjedisore të cilat impaktojnë komunitetet në territorin e vendit.

Për këtë arsye Partnerët GreenAL kanë dizenuar një skemë grantesh me disa nivele me qëllim që të jetë; a) e aksesueshme nga të gjitha OSHC-të, pavarisht përvojsës së tyre; b) ngritjen e problematikave të cilat shqetësojnë komunitetet në zonat rurale e urbane me synim gjithëpërfshirjen; c) advokimin nga niveli lokal në atë kombëtar për çështjet mjedisore. **Përfituese të skemës së granteve do të jenë Organizatat Jofitimprurëse (OJF) të regjistruara sipas ligjit nr. 8788 të datës 07.05.2011 "Për organizatat jofitimprurëse" në Republikën e Shqipërisë.** Shuma në dispozicion për të gjitha skemat e granteve në këtë projekt do të jetë **1,155,000 Euro.**




Figura 9: Ilustrim grafik i skemës së granteve GreenAL

Grante Tematike - mbështetje për OSHC-të që kanë në fokus dhe zotërojnë ekspertizë në një nga tre temat kryesore (Klima, Natyra, Ndotja); targetojnë organizata të konsoliduara të cilat kanë përvojë dhe ekspertizë të provuar në një nga fushat kryesore të interesit për GreenAL dhe do të angazhohen në procese në nivel kombëtar.

Mbështetja financiare për grant: deri në 60,000 Euro

Kohëzgjatja: 24 -30 muaj;

Fokusi: Advokim, ndikim në politikbërje, mentorim për organizata lokale, dialog në nivel kombëtar;

Partneriteti: sygjerohet partneriteti me institucione në nivel kombëtar/ lokal/, institucione akademike dhe kerkimore;

Projekte të financuara: 3 për një total prej 180,000 Euro.

Grante Rajonale - targetojnë organizata të konsoliduara të cilat kërkojnë të rritetohen me OSHC të tjera në fushën e tyre të veprimit, apo të ngjashme me të, të cilat tregojnë lidhje të forta me temën të cilën kërkojnë të adresojnë dhe duan të ndër marrin veprime konkrete për përmirësimin e situatës, monitorojnë situatën aktuale për të advokuar për përmirësimin e gjendjes.



Kujdes! Grant Rajonal nuk do të thotë domosdoshmërisht që projekti të zbatohet në një Qark por mund të jetë i zbatueshëm në disa Nj.A. Bashki, Qarqe.

Mbështetja financiare për grant: deri në 50,000 Euro me mundësi investimi deri në 25% të shumës së përfutur;

Fokusi: monitorim të komponentëve të ndryshëm mjedisor, dialog në nivel lokal/rajonar/kombëtar, vlerësimi i komponentëve mjedisor dhe promovimi i praktikave të mira, advokim, angazhim komunitar;

Kohëzgjatja: 18 - 24 muaj;

Partneriteti: 1 detyrueshëm ndërmjet OSHC-ve (1 lider dhe 2 bashkë-aplikantë) dhe opsionale me institucione lokale/ rajonale;

Projekte të financuara: deri në 12 për një total prej 600,000 Euro.

Grante të Iniciativës - targetojnë organizata lokale/grassroot të cilat përfaqësojnë interesat e komuniteteve lokale dhe duan të evidentojnë problematika mjedisore të cilat prekin këto komunitete;

Mbështetja financiare për grant: deri në 17,000 Euro;

Fokusi: ngritja e çështjeve lokale, angazhimi komunitar, vendim-marrje me pjesëmarrje, ndërgjegjësimi, monitoim dhe vlerësim i komponentëve/shërbimeve mjedisore;

Kohëzgjatja: 12 - 18 muaj;

Partneriteti: Nuk është i detyrueshëm por do të ishte një vlerë e shtuar bashkëpunimi me një nga grupet e interes të GreenAL;

Projekte të financuara: deri në 20 për një total prej 340,000 Euro.

Grante të Dedicuara/On the Spot Grants – targetojnë OSHC të cilat duan të adresojnë një çështje/problem emergjente mjedisore në një territor apo komunitet të caktuar apo në të gjithë vendin. Kjo skemë do të qendrojë e hapur nga momenti i publikimit deri në **30.06.2027** (në rastëse fondi i parashikuar për këtë skemë nuk ezaurohet më parë).

Mbështetja financiare për grant: deri në 5,000 Euro;

Fokusi: Çështje mjedisore emergjente të cilat kanë nevojë të sillen në vëmëndjen e publikut dhe institucioneve publike nëpërmjet fushatava advokuese, ndërgjegjësuere, angazhimit të të rinjve dhe komuniteteve, medias;

Kohëzgjatja: 3 - 6 muaj;

Partneriteti: Nuk e kanë të detyrueshme por mund të bashkëpunojnë me një nga grupet e interes të GreenAL;



Projekte të financuara: deri në 7 për një total prej 35,000 Euro.

Sa i përket shtrirjes kohore në të cilat do të publikohin thirrjet për grante, periudhat indikative janë paraqitur më poshtë. Për grantet Tematike dhe një pjesë të tyre Rajonale thirrja do të hapet në Shtator 2024; për grantet e Iniciativës dhe pjesën e mbetur të atyre Rajonale thirrja do të hapet në Mars/Prill 2025, ndërsa për grantet e Dedicuar do të jetë e hapur duke filluar nga Korriku 2024 dhe do të qendrojë e hapur deri në 6 mujorin e parë të 2027.




Figura 10: Ilustrim grafik i publikimit të thirrjeve për skemat e granteve në kuadër të GreenAL



3.8. Procesi i vlerësimit të projekteve

Thirrjet për skemën e granteve në GreenAL do të publikohen në faqen Web (GreenAL.al – GreenAL) dhe në kanalet e rrjeteve sociale të projektit, më qëllim informimin e sa më shumë organizatave apo ekspertëve të cilët duan të përfshihen në projekt. Çdo thirrje për grante do të ndiqet nga 1-2 sesione informuese për të lehtësuar aplikimin në këtë skemë grantesh. Të gjithë aplikimet e ardhura për skemat e granteve do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur nga Partnerët GreenAL i cili do të siguroj trajtim të barabartë të të gjithë aplikimeve dhe paanshmëri në vlerësim. Procesi i vlerësimit të propozimeve do të kalojë në disa faza të cilat ilustrohen më poshtë:

- 1- Dërgimi i konceptit (concept note) dhe dokumentacionit përkatës. Nëse aplikimi është konform formatit dhe të gjithë dokumentacioni është dërguar në formën dhe kohën e caktuar, propozimi kalon në vlerësimin përmbajtësor;
- 2- Vlerësimi dhe rankimi i aplikimeve;
- 3- Zhvillim i një dëgjese me aplikantët të cilët kanë kaluar kufirin e vlerësimit;
- 4- Njofimi i aplikimeve të cilët do të duhet të dërgojnë propozim të plotë;
- 5- Vlerësimi i aplikimeve të plota;
- 6- Negocimi i kontratës;
- 7- Firmosja e kontratave për propozimet fituese.

Procesi është menduar të kalojë në disa faza me qëllim që të sigurohet një cilësi e mirë e projekt propozimeve dhe mund të adresohen komente të ardhura nga Komisioni i Vlerësimit. Gjithashtu në procesin e vlerësimit është përfshirë edhe një dëgjese për ti dhënë mundësinë përfaqësuesve të organizatave të paraqesin idene e tyre dhe mënyrën së si ata kërkojnë ta aplikojnë atë.

4. Zbatimi dhe Monitorimi

Përfituesit e skemave të granteve do të bëhen pjesë e në procesi inkubimi ku do ti ofrohet një trajnim mbi menaxhimin e projektit, mënyrës së raportimit dhe dokumentimit të materialeve si për element teknik ashtu edhe ato financiar, gjithashtu edhe për promovimin e projekteve që do të zbatohen në kuadër të këtij programi. Me firmosjen e kontratës të gjithë përfituesve të granteve do ti kaloet seti me dokumenta i cili përmban të gjitha formatet e raportimit, teknik dhe financiar, si dhe manuali i komonukimit.

Duke reflektuar dhe gjithashtu marrë në konsideratë komentet e përfituesve të granteve gjatë fazës së parë, periudha e raportimit do të jetë 1 herë në 6 muaj (në varësi të kohëzgjatjes së projektit do të përshtatet edhe periudha e raportimit). Raportimi për komponentin teknik dhe financiar do të sigurojë që Partnerët GreenAL të monitorojnë zbatimin e projekteve dhe të ofrojnë mbështetje dhe mentorim për OSHC-të me qëllim arritjen e objektivave dhe përfshirjes së grupeve të interesit.

Mentorimi dhe mbështetja për përfituesit e granteve do të ofrohet nëpërmjet pikave fokale/pikat e kontaktit që Partnerët GreenAL kanë vendosur për secilin rajon, të cilat do të kujdesen që të mbështesin OSHC-të në organizimin e aktiviteteve, lajmërimin e grupeve të interesit, dizajnimin e materialeve apo fushatave promovuese etj.



Gjithashtu si një element tjetër i mbështetjes që GreenAL do të ofrojë për përfituesit e granteve do të jetë edhe përfshirja e tre ekspertëve tematik për tre fushat kryesore të projektit: ndryshimet klimatike, ndotja dhe natyra si dhe një ekspert për çështjet gjinore. Varësisht tipologjisë së projekteve që do të shpallen fitues ekspertët tematik do të mbështesin organizatat me ekspertizë më qëllim ngitjen e kapaciteteve apo përmirësimin e produkteve në varësi edhe të dëshirës dhe nevojës së organizatave.

Në përfundim, Partnerët GreenAL kanë parashikuar një sërë trajnimesh tematike i ideuar për të ndihmuar organizatat e reja, ekspert mjedisor, aktivist por edhe përfaqësues të institucioneve publike në rritjen kapaciteteve dhe përditësimin e njohurive lidhur me çështjet kryesore/aktuale mjedisore. Këto trajnime do të dizajnohen mbi nevojat e organizatave përfituese të granteve GreenAL më qëllim mbështetjen e mëtejshme të tyre duke adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat e tyre.

5. Këshilla për aplikantët

Shkrimi i projekt propozimeve nuk është gjithnjë një proces i thjeshtë, pasi nga njëra anë kërkohet të adresohen kërkesat e thirrjes për projekt propozime e nga ana tjetër është dëshira e organizatës për të zbatuar idenë e saj dhe zhvilluar aktivitete të cilat do të arrijnë objektivat e vendosur. Duke u gjendur përball këtyre dilemave shpesh nuk arrihen të adresohen as kërkesat e thirrjes a as idea fillestare nuk arrihet të përçohet në mënyrën e duhur. Partnerët GreenAL kanë dëshirë dhe kanë ngritur mekanizma që skemat e granteve të jenë gjithëpërfshirëse ku të gjitha organizatat aktive që operojnë në territorin e vendit të kenë mundësi të aplikojnë dhe zbatojnë idenë e tyre dhe do të ofrojnë përmes proceseve të konsultimit asistencë për ato OSHC-ë të cilat do të duan të validojnë idenë e tyre me qëllim përmirësimin e saj. Megjithatë disa këshilla të përgjithshme të cilat mund të merren në konsideratë nga organizatat janë paraqitur më poshtë:

Gabimet e zakonshme për t'u shmangur

- **Injorimi i udhëzimeve:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe sigurohuni që propozimi ti përmbahet formatit dhe procesit të specifikuar në udhëzues;
- **Mungesa e qartësisë dhe fokusit:** Propozimet që janë të paqarta ose nuk kanë një fokus të definuar mirë shpesh nuk janë fitues. Përcaktoni objektivat e projektit në mënyrë konçize dhe përdorni një gjuhë të qartë dhe drejtpërdrejtë në mënyrë që te jetë lehtësisht e kuptueshme për vlerësuesit;
- **Arsyetim i dobët:** Propozimet që nuk justifikojnë në mënyrë të qënësishme nevojën për projektin ose lidhjen e tij me qëllimet e thirrjes kanë pak gjasa të jenë të suksesshme. Jepni prova të forta të problemit që adreson projekti juaj. Përdorni të dhëna, raste studimore dhe referenca për të mbështetur pretendimet tuaja;
- **Qëllime tepër ambicioze:** Vendosja e objektivave jorealiste ose tepër ambicioze mund ta bëjë projektin tuaj të duket i perealizueshëm. Vendosni objektiva SMART (specifike, të matshme, të arritshme, relevante, të kufizuara në kohë). Sigurohuni që qëllimet tuaja janë realiste duke pasur parasysh kontekstin, kohën dhe burimet;
- **Buxhet jorealist:** Një buxhet i detajuar dobët ose që duket joreal mund të ndikoj negativisht edhe në një propozim të hartuar mirë. Sigurohuni që buxheti të jetë i mirë detajuar dhe i justifikuar;



- **Neglizhimi i artikulimit për qëndrueshmërinë e projektit:** Nëse nuk artikulonit dhe dëshmoni qartë qëndrueshmërinë e ndërhyrjes/projektit edhe pas përfundimit të projektit mund të jetë një element i cili ndikon negativisht në vlerësim.

Shkrimi i një propozimi të fortë

- **Filloni me një abstrakt të fortë:** Abstrakti ose përmbledhja ekzekutive duhet të ofrojë një pamje të qartë të projektit tuaj, duke theksuar rëndësinë e tij dhe ndikimin e potencial. Mund të zgjidhni të shkruani abstraktin në fund, pasi të keni përfunduar të gjitha seksionet e tjera, për t'u siguruar që ai kap thelbin e propozimit tuaj;
- **Narrativë bindëse:** Propozimi juaj duhet të ketë një narrativë bindëse e cila përfshin vlerësuesin nga fillimi në fund. Strukturoni narrativën tuaj në mënyrë logjike duke filluar me artikullimin e problemit, e ndjekur nga objektivat, metodologjia, rezultatet dhe ndikimi;
- **Metodologji e detajuar:** Shpjegoni qartë qasjen tuaj dhe si do t'i arrini objektivat tuaja. Ky seksion duhet të ngjall besim në aftësinë tuaj për të ekzekutuar projektin;
- **Theksoni ekspertizën dhe përvojën:** Shfaqni kualifikimet dhe përvojën e ekipit tuaj, kjo do të ndihmojë për të demonstruar se keni aftësinë për ta realizuar projektin me sukses;
- **Buxheti i qartë dhe realist:** Sigurohuni që buxheti të përputhet me planin e projektit tuaj dhe të jetë realist duke dhënë arsyetime të detajuara për çdo zë;
- **Promovimi i projektit:** Gjithnjë e më shumë është bërë e nevojshme që të parashikohen aktivitete apo materiale të cilat promovojnë aktivitetet dhe projektin në tërësi. Përfshirja e aktiviteteve/materiale promovuese në projekt propozim duke e lidhur mirë me aktivitetet kryesore të projektit me gjasë do t'ju ndihmojë në vlerësimin pozitiv të projekt propozimit.

Demonstrimi i ndikimit dhe qëndrueshmërisë

- **Përcaktoni qartë ndikimin:** Artikulonit qartë ndikimin e pritur të projektit tuaj në komunitetin e synuar ose zonën e problemit. Përdorni tregues të matshëm për të përcaktuar suksesin;
- **Dëshmoni nevojën për mbështetje:** Jepni dëshmi se ka një nevojë të vërtetë për projektin tuaj dhe se ai ka mbështetje nga palët e interesit. Mund të përfshini letra mbështetje nga komuniteti apo palët e interesit;
- **Menaxhimi i rrezikut:** Identifikoni rreziqet e mundshme për suksesin e projektit dhe propozoni masa zbutëse. Pranimi i faktorëve të rrezikut dhe evidentimi i masave për parandalimin e tyre është një element i fortë i projekt propozimit.

6. Komunikimi dhe promovimi i projektit/çështjeve mjedisore

Komunikimi efektiv është një element tepër thelbësor në zbatimin e projekteve në tërësi e veçanërisht në ato mjedisore duke shërbyer si një mjet për të promovuar praktikën e gjetjet por edhe për të ndërgjegjësuar grupet e interesit dhe qytetarët lidhur me impaktin e tij.

Komunikimi i qartë dhe transparent siguron që të gjitha palët të kuptojnë qëllimet, progresin dhe rezultatet e projektit, duke nxitur bashkëpunimin dhe mbështetjen. Ai gjithashtu ndihmon në



shpërndarjen e gjetjeve të projektit në një audiencë më të gjerë, duke përkthyer të dhëna komplekse në njohuri të zbatueshme që mund të informojnë politikat dhe veprimet e komunitetit.

Për më tepër, komunikimi është thelbësor për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore dhe nxitjen e mbështetjes publike. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla si organizimi i forumeve, konferencave, dëgjësave publike, marshime apo protesta paqësore, fushatave promovuese në rrjetet sociale e mediat tradicionale (radio dhe TV) si dhe programet mësimore, projektet mund të angazhojnë dhe fuqizojnë komunitetet për të qenë aktiv dhe vokal në çështjet mjedisore.

Duke e konsideruar komunikimin si një element shumë të fortë, Partnerët GreenAL synojnë që ai të jetë një nga elementët kryesor të këtij projekti. Për këtë arsye është ngritur një strategji komunikimi e projektit, që do t'i shërbej grupit të punës dhe një manual i komunikimit dhe vizibilitetit për përfituesit e granteve si udhëzues për çështjet e komunikimit në GreenAL.

Për të lehtësuar komunikimin ndërmjet të gjithë grupeve të interesit GreenAL do të ketë një faqe interneti ([GreenAL.al – GreenAL](http://GreenAL.al)) të dedikuar e cila do të shërbejë si dritarja kryesore e: a) ndërveprimit e rrjetëzimit me grupet e interesit; b) promovimit të nismave, praktikave të mira, historive të suksesit; c) publikimit e monitorimeve të cilat do të zhvillohen përgjatë kohëzgjatjes së projektit.




Figura 11: Foto e faqes së internetit të GreenAL

Një tjetër element i promovimit dhe komunikimit me grupet e interesit do të jenë edhe kanalet/faqet e dedikuara të projektit në rrjetet sociale. GreenAL do të ketë tre faqe sociale (Instagram, Facebook dhe YouTube) të cilat janë përzgjedhur për t'u hapur si faqe për shkak të numrit të lartë të përdoruesve që kanë nga ana e qytetarëve Shqiptarë.



[@green_al](https://www.instagram.com/green_al)



[Green-AL](https://www.facebook.com/Green-AL)



[@Green_AL](https://www.youtube.com/@Green_AL)

Gjithashtu përtej kanaleve të komunikimit të përmendura më sipër, çdo person apo përfaqësues i një organizate apo grupi interesi mund të komunikojë me grupin e punës së GreenAL në adresën e email-it: Info@greenal.al.

Kjo adresë gjithashtu do të shërbejë dhe është e hapur për të gjithë individët dhe/ose organizatat e shoqërisë civile që duan të ndajnë një problematikë mjedisore të evidentuar e cila shqetëson komunitetin e prekur. Çështjet e ngritura do të vlerësohen nga grupi i punës dhe nëse problematika është relevante GreenAL do të përdori kanalet e komunikimit të sajat dhe partnrëeve për ta bërë mediatike këtë çështje.

Çdo informacion/media e ndarë në këto rrjete do përfshijë hashtagun kryesor #GreenAL me qëllim identifikimin nga grupi i punës dhe ripostimin në rrejtet sociale të projektit.